STUDENTI

Gazetë e studentëve të AAB-së, 31 dhjetor 2014, Nr.2, Viti III

Urimet e stafit menaxherial të AAB-së për Vitin e Ri 2015

faqe 12

Prof. Ellen Schmider: Në AAB bëhet punë e madhe

faqe 5

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, mbajti ligjëratë për studentëte AAB-së

faqe 7

Në AAB u mbajt tryeza "Përparësitë e gazetarisë online përballë mediave tradicionale"

faqe 9

Majlinda Kelmendi kampione absolute e xhudos në botë

faqe 21

Ambasadori Vodopija: Me eksod masiv nuk ka perspektivë liberalizimi i vizave

"Kroacia është lobues i Kosovës në çdo organizëm ndërkombëtar. Pranimi i Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar është edhe kontribut i Kroacisë". Kësh-tu tha ambasadori kroat në Prishtinë Zoran Vodopija në...

faqe 10

"Mendja e shprisht" fitoi çmimin për filmin më të mirë

Në një ceremoni solemne të organizuar në ambientet e AAB-së, para të pranishmëve si studentë e profesorë të këtij institucioni, u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve kryesore për kategorinë e filmit shkurtër, të punuar nga studentët e vitit të parë, të Fakultetit Komunikim Masiv dhe Gazetari dhe Fakulteti Produksion...

faqe 15

Përfaqësuesja e ICTY-së, Emiliya Viktorova, u ligjëroi studentëve të AAB-së

Fakultet Juridik në AAB organizoi ligjëratë profesionale me temën "Gjykimi ndaj gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve në luftë", në të cilën referoi përfaqësuesja e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), Emiliya Viktorova.

Viktorova foli për vështirësitë dhe për përparësitë e jashtme dhe të brendshme që përbëjnë pengesë ose përparim në këtë proces, duke marrë shembuj konkretë ndaj gjykimit të dhunës seksuale gjatë kohës së luftës, menaxhimin e lëndëve, konfirmimin e procesit të aktakuzës, deklarimin e fajësisë dhe të dënimit, shpërfillje të gjykatës, mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarit, procedimin e lëndëve nga prokuroria e gjykatës dhe pikat kyçe në jurisprudencën në ICTY etj.

Në këtë ligjëratë u shfaqën edhe disa video të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi që kishin ndodhur në Bosnjë dhe Kosovë dhe disa sekuenca dëshmi të disa dëshmitarëve gjatë gjykimit në Tribunalin e Hagës, dhe më pas se si ky institucion i ka shqyrtuar dhe çfarë vendimesh ka marrë ndaj këtyre krimeve.

Ajo në këtë ligjëratë ka folur edhe për historikun e themelimit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), e themeluar nga OKB-ja dhe si mund të vazhdojë bashkëpunimi me të pranishmit e tjerë nëpërmjet uebfaqes së ICTY-s, për punë profesionale, hulumtuese dhe shkencore.

Përfaqësuesja e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), Emiliya Viktorova, u përgjigj edhe në një varg pyetjesh e çështjesh të shtruara për diskutim nga pjesëmarrësit, profesorët dhe studentët e AAB-së.

Këshilltari në Kryeministri të Republikës së Kosovës, Alastair Livingston, vizitoi AAB-në

Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, këshilltari i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Alastair Livingston, vizitoi AAB-në. Ai u takua me prorektorin për bashkëpunim të AAB-së, Xhavit Rexhaj dhe Ganimete Ismajli, asistente në AAB.

Z. Livingston u informua për programin e studimeve të drejtësisë në gjuhën boshnjake/malazeze e serbe në AAB. Më konkretisht, gjatë këtij takimi u diskutua për veprimtarinë e ndërsjellë dhe mundësinë e bashkëpunimit në avancimin e arsimit të pjesëtarëve të komuniteteve në nivelin e arsimit të lartë.

Zt. Livngston doli me përshtypjet më të mira dhe me gatishmërinë për të bashkëpunuar me AAB-në në drejtim të avancimit dhe forcimit të këtij programi. Prorektori Rexhaj gjatë këtij takimi ka folur për zhvillimet dhe të arriturat e AAB-së prej fillimit të punës së saj.

Impresum

STUDENTI
Gazetë e studentëve të AAB-së

Botues: BPrAL AAB

Kryeredaktor: Zija Rexhepi

Redaktore përgjegjëse: Naile Demiri

Gazetën e përgatitën studentët e AAB-së

Foto:
Rrahman Drenica dhe Ylli Selmani

Dizajni grafik:
Besfort Mehmeti

e-mail: info@aab-edu.net

Në AAB u mbajt prezantimi për programin Kosovo UGRADE

Përfaqësuesit e projektit Kosovo UGRAD Program para studentëve të AAB-së e kanë prezantuar mundësinë e përfitimit të bursave njëvjeçare për studime në universitetet e SHBA-ve për studentë të nivelit bachelor.
Jessica Yonke, përfaqësuese e projektit, i ka njoftuar studentët për kriteret e aplikimit në fushat e caktuara studimore. "Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e vitit të parë dhe të dytë të nivelit bachelor, dhe informata shtesë mund të merrni në uebfaqen www.irex.org.
I njëjti prezantim u realizua edhe në kampuset e AAB-së në Ferizaj dhe Gjakovë.
Projekti Kosovo UGRAD Program, i cili është program i përbashkët i SHBA-ve, Seksionit për Marrëdhënie me Publikun të Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe Departamentit të Shtetit të ShBA, implementohet nga IREX.

Studentët e AAB-së u trajnuan nga ekspertët e jashtëm për karrierë

Më qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndërinstitucional mes institucioniit arsimor të shkollimit të lartë AAB-së dhe projektit TEMPUS LO@HEI, për studentët e AAB-së u organizua trajnimi me temën "Ngritja e shkathtësive për ndërtim të suksesshëm të karrierës", me theks të veçantë në zhvillimin e karrierës, shkathtësive të prezantimit dhe për komunikimin biznesor.
Me këtë rast ligjëruan profesoresha nga Universiteti i Korkut, prof. dr. Norma Ryan, prof. dr. Mariana Mocanu, nga Universiteti Politeknik i Bukureshtit, dhe përfaqësues të TEMPUS-it nga Kosova.
Trajnimi kishte për qëllim që studentët të fitojnë sa më shumë njohuri nga të tri fushat e cekura më lartë, me qëllim që ata të pajisen me shkathtësi të nevojshme për tregun e punës.

AAB-ja nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Institutin Shqiptar të Sociologjisë

Përfaqësuesit e projektit Kosovo UGRAD Program para studentëve të AAB-së e kanë prezantuar mundësinë e përfitimit të bursave njëvjeçare për studime në universitetet e SHBA-ve për studentë të nivelit bachelor.
Jessica Yonke, përfaqësuese e projektit, i ka njoftuar studentët për kriteret e aplikimit në fushat e caktuara studimore. "Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e vitit të parë dhe të dytë të nivelit bachelor, dhe informata shtesë mund të merrni në uebfaqen www.irex.org.
I njëjti prezantim u realizua edhe në kampuset e AAB-së në Ferizaj dhe Gjakovë.
Projekti Kosovo UGRAD Program, i cili është program i përbashkët i SHBA-ve, Seksionit për Marrëdhënie me Publikun të Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe Departamentit të Shtetit të ShBA, implementohet nga IREX.

AAB në përkrahje të grave police të Republikës së Kosovës dhe familjarëve të tyre

Me qëllim të ngritjes profesionale dhe shkollimit të mëtutjeshëm të shoqërisë kosovare, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndërinstitucional në mes të AAB-së dhe Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës (SHGPK).
Marrëveshja u nënshkrua në ambientet e AAB-së nga prorektori për Marrëdhënie me Jashtë, prof. Xhavit Rexhaj, si dhe kryetarja e SHGPK-së, kolonel Taibe Canolli.
Marrëveshja në fjalë do t' u mundësojë lehtësime financiare anëtarëve të SHGPK-së dhe familjarëve të tyre në të gjitha programet bachelor dhe master, ndërsa fëmijëve të policëve të rënë në detyrë, do t' u mundësohen studime pa pagesë. Marrëveshja gjithashtu, ofron përkrahje edhe për anëtarët e SHGPK-së që i takojnë komunitetit serb dhe boshnjak për studime në gjuhën boshnjake në Fakultetin Juridik.
Përfaqësuesit e SHGPK-së janë shprehur të kënaqur me arritjen e marrëveshjes, duke pasur parasysh të arriturat e AAB-së, me theks të veçantë në programet e studimit, teknologjinë dhe me infrastrukturën moderne, stafin akademik dhe me arritjet e studentëve të diplomuar. Marrëveshja do të fillojë implementimin nga ky vit akademik.

Georgi Koritarov u ligjëroi studentëve të AAB-së

Gazetari dhe publicisti i mirënjohur bullgar, Georgi Koritarov, mbajti një ligjëratë para studentëve të Fakultetit të Gazetarisë të AAB, me temën "Demokracia, Ballkani drejt Evropës".
Koritarov gjatë ligjëratës foli kryesisht për përvojën e tij të kohës para 15 vjetësh, kur Kosova ishte në luftë me Serbinë si dhe për intervistat e tij me figurat politike të Kosovës si me ish-kryeministrin në ekzil, Bujar Bukoshin, më pas me ish-presidentin Ibrahim Rugova dhe me Fehmi Aganin.
Ndërkaq, gjatë kësaj kohe, Koritarov sa kishte punuar për radion "Evropën e lirë" në gjuhën bullgare, kishte kontaktuar edhe me personalitete serbe të ushtrisë dhe politikës së asaj kohe. Koritarov u tha studentëve të AAB-së se në atë kohë si temë të hulumtimeve të tij gazetareske i kishte komplet zhvillimet që po ndodhnin atëherë në ish-Yougosllavi.
Ai në këtë ligjëratë foli edhe për politikën e BE-së karshi Ballkanit, ku tha se për pesë vjetët e ardhshme nuk do të ketë zgjerim, mirëpo sipas tij, viti 2014 është si një fillim i mbarë që dy shtetet që dikur kanë qenë në armiqësi të mos pengojnë njëra tjetrën për t'u integruar, duke e marrë për shembull marrëdhëniet Greqi-Maqedoni.
Koritarov, para studentëve të gazetarisë tha se gazetaria hulumtuese është armë e fortë kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe të gjithë armiqve të demokracisë, mirëpo sipas tij, efekt më të madh do të ketë kur Kosova të jetë pjesë e BE-së dhe e NATO-s. Ai foli edhe për përvojat e tij në këtë sektor të gazetarisë duke mos i anashkaluar edhe rreziqet që sjell, duke thënë se "pothuajse të njëjtat përvoja të lirisë së shtypit pas kaq vitesh mund të vërehen tani në edhe Kosovë".
Në këtë ligjëratë, pos studentëve dhe stafit të AAB-së, prezent ishte edhe ambasadori i Bullgarisë në Republikën e Kosovës, si dhe ish-kryeministri në ekzil, Bujar Bukoshi. Në fund të ligjëratës u zhvillua edhe një debat ku studentët e AAB-së parashtruan pyetje të cilave iu përgjigj gazetari dhe publicisti bullgar, Georgi Koritarov.

Nxënësit e Lipjanit vizituan AAB-në dhe takuan robotët NAO

Një grup prej disa nxënësve nga Shkolla Fillore "Ismail Luma" nga Komuna e Lipjanit, krahas aktiviteteve jashtëshkollore kanë bërë një vizitë në AAB.
Ata u pritën nga prorektori për Çështje Mësimore, prof. ass. dr. Shemsedin Vehapi, i cili i njoftoi nxënësit për përvojën dhe fillimin e punës si dhe konceptin dhe synimet e AAB-së, si dhe për programet që ofrohet nën ombrellën e këtij institucioni.
Ndërsa dekani i Fakultetit të Shkenca Kompjuterike, prof. dr. Ermir Rugova, nxënësit i njoftoi në përgjithësi për robotët NAO, dhe fushën e teknologjisë që ka ky institucion, dhe rëndësinë e kësaj teknologjie për kohën që po jetojmë dhe në të ardhmen.
Përveç vizitës nxënësit si shenjë respekti AAB-së i dhuruan punime të shumta nga lënda e teknologjisë, si një robot të punuar nga plastika, raketë të punuar nga druri, punim të punuar nga druri në mënyrë hidraulike.

Në AAB u prezantua programi i bursave të USAID-it "Transformational Leadership Program"

Në kuadër të projekteve të shumta për studime jashtë vendit dhe në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme drejt ndërkombëtarizimit të AAB-së, para studentëve të këtij institucioni, më të madhit në vend nga institucionet jopublike, u mbajt prezantimi i programit të bursave "Transformational Leadership Program", që mbështetet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe USAID-i.
AAB është institucioni i parë jopublik në Kosovë, të cilit i jepet mundësia,përmes këtij projekti, që studentët e tij të aplikojnë për bursa për vazhdimin e studimeve në universitetit amerikane.
Fushat e studimit, të cilat mund të aplikojnë studentët e AAB-së për vazhdimin e këtyre studimeve, përputhen me fushat e studimit, të cilat ofrohen edhe në AAB, siç janë: juridiku, administrata publike, inxhinieria kompjuterike, menaxhimi i biznesit, financat, ekonomia,sistemet e informacionit dhe arsimi.
Kanishka Gangopadhyay dhe Mary Tyler Holmes, përfaqësuese të projektit, i njoftuan studentët dhe mësimdhënësit e AAB-së, për kriteret e aplikimit në fushat e caktuara studimore. Po ashtu ata kanë dhënë detaje të hollësishme deri te përfitimi i kësaj burse, akomodimin e tyre në SHBA dhe për përfitimet e tyre pas mbarimit të studimeve.
Ata kanë bërë me dije se të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e AAB-së, të cilët i përfundojnë studimet e nivelit bachelor e të cilët flasin gjuhën angleze.
Kanishka Gangopadhyay dhe Mary Tyler Holmes kanë treguar se projekti më vlerë prej 28 milionë dollarësh, është pesëvjeçar dhe në përgjithësi ofron bursa master dhe bursa për studime për certifikatë deri në kohëzgjatje prej një viti.
Interesimi i studentëve të AAB-së për projektin në fjalë ishte i jashtëzakonshëm.
Informata shtesë në lidhje me projektin në fjalë mund të gjenden në uebfaqen http://www.usaid-tlp-sp.org/

Intervistë me profesoreshën nga SHBA-ja, Marry Ellen Schmider

Prof. Ellen Schmider: Kam vërejtur se këtu në AAB bëhet një punë e madhe për të krijuar një standard dhe një mënyrë se si duhet bërë edukimi

"AAB është universiteti më i madh privat në të gjithë regjionin. Kam vërejtur se këtu bëhet një punë e madhe për ta krijuar një standard dhe një mënyrë sesi duhet bërë edukimi, e gjithashtu edhe kushtet e krijuara iu mundësojnë studentëve studime të mira", ka thënë ndër të tjera profesoresha Marry Ellen Schmider, në intervistën për gazetën "STUDENTI".

"STUDENTI": E nderuara profesoreshë Marry Ellen Schmider, ne jemi në dijeni për veprimtarinë tuaj të pasur akademike, por a mund të na thoni diçka më shumë. Në çfarë jeni fokusuar më tepër gjatë punës në vendin tuaj?

Prof. Schmider: Në vendin tim kam punuar për shumë vite në kolegj. Pata filluar në moshën 23-vjeçare në një kampus të ri ku ligjëroja gjithçka që kishte të bënte me fushën e anglishtes dhe deri në vitin e kaluar isha atje. Atëherë isha 24 vjeçare dhe ligjëroja rreth shumë gjërave. Ishte një mënyrë shumë e tendosur për të filluar karrierën dhe që nga atëherë, afro 30 vjet, kam bërë shumë gjëra, kam punuar kryesisht në kthimin e studentëve të rritur në studime, studentët të cilët janë me korrespodencë, të cilët përveç studimeve merren edhe me gjëra të tjera në jetën e tyre njëkohësisht, e që gjithashtu kanë dëshirë ta gjejnë kohën dhe energji për t'i vazhduar studimet. Pra gati se kam specializuar me studentët që kërkojnë shansin e dytë të jetesës së tyre dhe që dëshirojnë të vazhdojnë shkollimin e tyre.

"STUDENTI": Si erdhi deri te bashkëpunimi me AAB-në?- Na e shpjegoni pak këtë bashkëpunim?

Prof. Schmider: Sigurisht. Një vit e gjysmë më parë kur unë isha drejtoreshë ekzekutive e Asociacionit Ndërkombëtar "Fulbright", i cili është një program studimor, isha duke jetuar në Uashington DC, dhe mora një letër nga një kolege nga Tetova e Maqedonisë, që thoshte se "jemi duke bërë një asociacion për studimet amerikane në Evropën Juglindore, a do të vini?".

Kam dhënë një çmim "Fulbright" në Shkup në vitin 2005, kështu që ajo më njihte nga atje dhe nga ligjëratat e mija në Tetovë. E pranova ftesën dhe erdha. Në atë kohë isha udhëheqëse e asociacionit "Fulbright". Vazhdova në këtë regjion për një vit, duke pasur takime të mrekullueshme me njerëz nga Kroacia, Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Mbajtëm një seri ligjëratash studimore në disa vende të cekura si më lartë dhe krahas ligjëratave u takuam me profesorë dhe drejtorë, kështu që ata më ftuan përsëri.

Gjashtë muaj më vonë, në mars të vitit 2013 erdha përsëri, Xhavit Rexhaj, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar në AAB dhe na ftoi të gjithëve të vijmë në AAB. Ishte një ftesë e këndshme për të gjithë ne që të vijmë këtu. Fillova ditën tjetër ta shoh nga pak Kosovën dhe ai tentonte të më bindte të kthehem përsëri këtu e ta filloj ligjërimin dhe ja ku jam.

"STUDENTI": Si ndiheni me punën tuaj në AAB?

Prof. Schmider: Është diçka interesante. Studentët janë shumë miqësorë dhe shumë bashkëpunues. Fakulteti është i shkëlqyer dhe jam pritur shumë mirë.

Stafi akademik këtu është i shkëlqyeshëm, janë shumë mirë të përgatitur, shumë ndërkombëtarë (të ndërkombëtarizuar), shumë mirë të edukuar, folës të mirë të gjuhës angleze. Gjithashtu është një eksperiencë shumë e mirë për mua.

"STUDENTI": Duke pasur tërë këtë eksperiencë në ligjërim në vendin tuaj, a mund të krahasoni sistemin edukativ në nivelet e larta në mes Kosovës dhe vendit tuaj, duke përfshirë gjithashtu infrastrukturën, stafin akademik dhe motivimin e studentëve?

Prof. Schmider: Stafi akademik këtu është i shkëlqyeshëm. Së pari kam njohur stafin e Fakultetit të Anglishtes,pasi vetë ndodhem këtu, por gjithashtu njoh edhe disa profesorë të tjerë që vijnë për ligjërata nga Maqedonia, me të cilët kam punuar në Tetovë e të cilët kur më shihnin më thoshin: "OhMarry Ellen, je kthyer!". Stafi akademik këtu janë shumë mirë të përgatitur, shumë ndërkombëtarë (të ndërkombëtarizuar),shumë mirë të edukuar, folës të mirë të gjuhës angleze. Gjithashtu është një eksperiencë shumë e mirë për mua.

"STUDENTI": Çfarë mendoni ju, sa i përgatit studentët për profesionin e tyre dhe për tregun e punës, programi studimor i Gjuhës Angleze, në të dyja nivelet e studimeve, bachelor dhe master?

Prof. Schmider: Nëse aftësitë tuaja të gjuhës angleze arrijnë nivele të mira, nëse mësohet gjuha angleze mirë në të folur, në atë mënyrë që të jetë e kuptueshme për njerëzit që nuk vijnë nga këtu, juve ju krijohet mundësia të punoni gati se kudo, ku aftësitë e gjuhës nevojiten. Në anën tjetër, nëse fokusi juaj është në literaturë, arsyeja e parë do të ishte që ju doni të njihni njerëz, të mësoni për ta dhe për vendet e tjera, sepse keni lexuar për ta, por nuk mund t'i njihni nga afër, t'i përjetoni, por mund t'i imagjinoni nëpërmjet fjalëve dhe kjo është ajo që unë e quaj "studime liberale", hapjen e mendjes tuaj kundrejt llojllojshmërisë së eksperiencave të njerëzve dhe mendoj se kjo ndihmon pavarësisht se çfarë bëni. Pyetja për tregun e punës, është e mirë. Nëse keni diplomë të master-it në Gjuhë Angleze dhe Letërsi, do të bëheni ligjërues i mirë. Me aq sa kam kuptuar, ligjërimi i gjuhës angleze në shkolla këtu është shumë i rëndësishëm dhe një nevojë e madhe për Kosovën, kështu që kushdo që ka një diplomë të master-it të gjuhës angleze dhe letërsisë, mendoj se ka oferta të mira në gjetjen e një pune të mirë.

"STUDENTI": Pothuaj secili maturant e sheh veten si student të AAB-së. Ju si e keni parë AAB-në në këtë aspekt?

Prof. Schmider: Mesa jam në dijeni, AAB është universiteti më i madh privat në të gjithë regjionin. Kam vërejtur se këtu bëhet një punë e madhe për ta bërë një standard dhe një mënyrë se si duhet bërë edukimi, e gjithashtu edhe kushtet e krijuara u mundësojnë studentëve studime të mira.

"STUDENTI": Cili është mesazhi për studentët tuaj në AAB dhe studentët e Kosovës në përgjithësi?

Prof. Schmider: Mund t'ju them se keni një mundësi të shkëlqyer, të mendoni, lexoni, flisni me njerëz të tjerë dhe të dëgjoni e zgjeroni vizionin tuaj sa më shumë që mundeni për jetën tuaj dhe ju duhet të merrni të gjithë këtë avantazh që ju ofrohet.

Intervistoi: Granit Zeka, student i vitit të dytë në Fakultetin e Komunikimit Masiv dhe Media në AAB

Studentët e AAB-së debatuan me ish-gjeneralin Grahovac

Një grup studentësh dhe ligjëruesish të Fakultetit Juridik të AAB-së, kanë marrë pjesë në konferencën "Ballkani dhe sfidat nga gjeopolitika" e organizuar nga Asociacioni Euroatlantik i Kosovës (KEAA). Gjatë kësaj konference ata e kanë dëgjuar ligjëratën e ish-gjeneralit Blagoje Grahovac.
Studentët e AAB-së, përveç tjerave, patën mundësi të inkuadrohen në debat rreth kësaj teme rreth problemeve gjeopolitike të shteteve ballkanike dhe njëkohësisht shprehën mendimet rreth temës në fjalë. Në fund të punimeve të konferencës, ish-gjenerali kroat Grahovac, nëpërmjet studentëve si shenjë respekti dhe falënderimi, AAB-së ia dhuroi librin e tij me titull "BRACA PO GLUPOSTI".
Punimet e konferencës u zhvilluan në ambientet e Ministrisë së Forcës dhe të Sigurisë së Republikës së Kosovës.

Studentët e Fakultetit Ekonomik në AAB realizuan vizitë studimore në fabrika të prodhimit

Studentët e Fakultetit Ekonomik në AAB, në kuadër të lëndës "Ndërmarrësia dhe NVM-të", vizituan fabrikën për prodhimin e mobileve"ELNOR" dhe fabrikën për prodhimin e birrës "BIRRA PRISHTINA", ku për së afërmi janë njohur me zhvillimin e këtyre fabrikave, që nga fillimi i punës, proceset e deri në ditën e sotme. Studentët u njoftuan me procesin e prodhimit nga furnizimi me lëndën e parë deri te prodhimi i produktit të gatshëm si dhe punët tjera administrative në menaxhimin e ndërmarrjes, krijimin e biznesit, konkurrencën, plasmanin e produkteve, ambientin biznesor. Gjatë kësaj vizite drejtuesit e fabrikave në fjalë, i njoftuan studentët edhe me objektivat zhvillimore dhe aktivitetet vepruese që këto fabrika do t'i kenë në periudhën vijuese konform planeve të tyre. Gjithashtu u përkrahë iniciativa e studentëve që në të ardhmen për studentet në këto fabrika të zhvillojnë vizita studimore , hulumtime shkencore, dhe punë tjera profesionale..

AAB-dega në Gjakovë, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë "Euro Konto"

Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në pajtim me qëllimet dhe interesat e përbashkëta, drejtori i degës së AAB-së në Gjakove, Jusuf Qarkaxhija, dhe koordinatori i Zyrës për Çështje studentore në AAB, Burim Vokrri, në një takim me drejtorin e "Euro Konto" në Gjakovë, Zenel Morina, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është krijimin e kushteve sa më të mira për studentët e AAB-së, për të mbaruar mësimin praktik në "Euro Konto" në Gjakovë, në sektorin e kontabilitetit, si dhe në krijimin e mundësive për punësimin e të rinjve që përfundojnë studimet në AAB. Sipas palëve nënshkruese të të dyja institucioneve, ky ishte vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.

Studentët e AAB-së në ceremoninë e 102 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

Në kuadër të aktiviteteve të nëntorit, një grup studentësh të departamentit të Shkencave Politike dhe të Diplomacisë në Fakultetin e Administratës Publike në AAB, të shoqëruar nga dekani i këtij fakulteti Petrit Bushi, kanë marrë pjesë në ceremoninë e madhështore për 102 Vjetorin e Pavarësisë, organizuar nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi. Studentët e AAB-së, përveç njohurive të fituara për organizimin të një feste të karakterit shtetëror, patën rastin të takohen edhe me ambasadorin Minxhozi, dhe të debatojnë rreth kësaj date historike. Njëkohësisht studentët shprehën mendimet rreth temës në fjalë, ndërsa takuan edhe përfaqësues të institucioneve të vendit dhe ndërkombëtar, përfaqësues të universiteteve partnere të AAB-së etj. Ceremonia është mbajtur në ambientet e hotelit "Emerald" në periferi të Prishtinës.

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, mbajti ligjëratë për studentëte AAB-së

Shqipëria mendon që të jetë pjesë e BE-së brenda 10 vjetëve të ardhshme, kështu tha ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, gjatë një ligjërate për studentët e AAB-së, të mbajtur në prag të festës së Flamurit Kombëtar. Arsyet për këtë janë sepse klasa politike në Shqipëri gjatë 20 vjetëve nuk u janë përgjigjur apelit të popullsisë për një hyrje sa më të shpejtë në BE me masa konkrete të karakterit politik, ekonomik e shoqëror. "Shqipëria është vendi i parë në Evropë që ka 97.5% i popullatës që dëshiron të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. Tani, më në fund, ne jemi në kampin e vendeve që bëjnë përpjekje të mëdha për tu bërë pjesë e BE-së", ka thënë Minxhozi. Ndërkohë, Minxhozi theksoi se politika e jashtme e Shqipërisë synon që gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të jenë pjesë e BE-së: "Ashtu siç ne kemi nevojë të jemi pjesë e familjes evropiane, ashtu edhe BE-ja ka shumë nevojë për të inkuadruar në familjen e saj edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Është një përfitim i dyanshëm", vlerësoi ambasadori shqiptar. Sipas tij, sfida për vendet e Ballkanit Perëndimor për të qenë pjesë e BE-së, është bërë shumë më e imët, duke pasur parasysh se çfarë ka ndodhur me pranimet e reja të fundit të Hungarisë dhe Rumanisë, BE-ja i ka ndaluar hapat për vendet e tjera aspirante. Por, sipas ambasadorit Minxhozi, kjo nuk do të thotë që BE-ja nuk i inkurajon vendet e Ballaknit Perëndimor, ndër to dhe Shqipërinë, për të qenë pjesë e familjes evropiane. Në këtë ligjëratë, ambasadori shqiptar foli edhe për qëndrimin që mban Shqipëria sa i përket çështjes së Kosovës, duke shtuar se pranimi i realitetit nga ana e Serbisë do të kontribuonte në shtimin e bashkëpunimit rajonal në të gjitha fushat. "Procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë është një prioritet për politikën e jashtme të Shqipërisë. Po ashtu edhe problemet mes Maqedonisë dhe Greqisë", tha ambasadori shqiptar. Duke folur për politikën e jashtme të Shqipërisë, ambasadori shqiptar në Kosovë, theksoi se politika e jashtme e Shqipërisë është konsoliduar dhe dalë ngadalë po bëhet zëdhënëse e problemeve rajonale. Minxhozi në këtë ligjëratë foli edhe për standardizimin e kurrikulave të përbashkëta mes dy vendeve në fushën e arsimit, si dhe për bashkëpunimin në fushat e tjera, si në atë të ekonomisë, biznesit, turizmit, etj.. Në fund të kësaj ligjërate pati edhe debat ku studentët parashtruan pyetje të cilave iu përgjigj ambasadori shqiptar në Kosovë, Qemal Minxhozi. Me përfundimin e kësaj ligjërate, studentja, Nazlishahe Thaçi, i dhuroi një pikturë diplomatit shqiptar. Ambasadori z. Minxhozi, ka takuar edhe menaxhmentin e lartë të AAB-së, me të cilët ka biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit në fushën akademike, shkencore dhe atë kulturore. Në fund të vizitës, z. Minxhozi u shpreh i kënaqur më të arriturat dhe punën që bëhet në këtë institucion të arsimit të lartë.

Studentët e Fakulteti Juridik të AAB-së publikuan të dhënat e hulumtimit "Frika nga krimi-naliteti"

Studentët e vitit të katërt të Fakulteti Juridik të AAB-së, të udhëhequr nga ligjëruesi i lëndës Mensut Ademi, në ambientet e kampusit universitar të AAB-së në Gjakovë, prezantuan të dhënat e hulumtimit"Frika nga kriminaliteti". Në këtë hulumtim, janë pasqyruar ndjenjat e banorëve të Gjakovës në kontekstin se si ata e perceptojnë sigurinë dhe mjedisin ku jetojnë; besueshmërinë ndaj Policisë së Kosovës (PK) si dhe agjencive të tjera për zbatimin e ligjit; marrëdhënieve në komunitete dhe marrëdhënieve ndëretnike, çështjet socio- ekonomike etj. Gjithashtu është pasqyruar dhe janë analizuar pikat më të forta dhe problematike si sfidat me të cilat ballafaqohet banori i Kosovës,si dhe identifikohen një numër rekomandimesh, për të fuqizuar punën e agjencive të zbatimit të ligjit në të ardhmen. "Ky punim hulumtues ka pasur një ndikim të rëndësishëm në çështjet e sigurisë dhe rritjes së kualitetit të jetës tek banorët e Kosovës, sidomos ne komunat ku është implemetuar hulumtimi, dhe prej nga veçohen sfidat që paraqiten para shoqërisë Kosovare", tha udhëheqësi i projektit Mensut Ademi. Hulumtimi "Frika nga kriminaliteti", është realizuar në kudër të Qendrës për Hulumtime në Fakultetin Juridik të AAB-së, dega në Gjakovë

AAB pjesëmarrëse në trajnimin e TEMPUS në Austri

Udhëheqësi i Zyrës për Sigurimin e Cilësisë në AAB, Alban Asllani, , nëpërmjet projektit "TEMPUS", ka marrë pjesë në trajnimin për zhvillimin e metodave të vlerësimit të metodologjisë së mësimdhënies me anë të hulumtimeve, dhe kyçjen e studentëve në hulumtime për mësimnxënie, në Universitetin e Salzburgut të Austrisë. Trajnimi gjithashtu kishte për qëllim mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së Cilësisë në AAB, si dhe mundësinë e bartjes së njohurive të fituara dhe aplikimi i tyre në vendin e punës. Trajnimi në fjalë është organizuar nga WUS Kosova dhe Universiteti i Salzburgut në Austri.

AAB- dega në Gjakovë, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me DKA në Gjakovë

Koordinatori i Zyrës për çështje studentore në AAB, Burim Vokrri, në një takim me drejtoreshën e Drejtorisë Komunale për Arsim në Komunën e Gjakovës, Diana Qarkaxhija, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është krijimi i mundësisë për studentët e AAB-së, për të mbaruar mësimin praktik në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjakovë, në sektorin e arsimit, si dhe në krijimi i mundësive për punësimin e të rinjve që përfundojnë studimet në AAB. Sipas palëve nënshkruese të të dyja institucioneve,ky ishte vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.

AAB trajnon zyrtarët e lartë administrativë

Në kuadër të bashkëpunimit me Institutin për Administratë Publike, stafi akademik i Fakultetit të Administratës Publike në AAB, kanë mbajtur një trajnim profesional për stafin dhe zyrtarët e lartë të IAP të Kosovës. Trajnimi "Ngritja e efikasitetit të Administratës Publike në Kosovë" ka ndihmuar zyrtarët administrativë në skanimin e gjendjes së tanishme të administratës publike në Kosovë, duke përfshirë përparimet, sfidat dhe ngecjet me qëllim të gjetjes së shkaqeve të cilat sfidojnë reformimin e administratës drejt ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të saj. Për më tepër, trajnimi ka ndihmuar në identifikimin e zbraztësirave ligjore në fushën e administratës publike duke vijuar me ndërveprimin mes politikës dhe aparatit administrativ në Kosovë. Avni Alidema, mësimdhënës në AAB, njëri nga pjesëmarrësit në këtë projekt në cilësinë e trajnuesit, tha se trajnimi është pritur pozitivisht nga zyrtarët administrativë sepse ka ndihmuar në identifikimin e sfidave dhe kristalizimin e mënyrave për tejkalimit e tyre në administratën publike. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të ndikojnë si katalizatorë të reformës së administratës duke kontribuar thelbësisht në ofrimin e shërbimeve më të mira qytetarëve dhe zbatimin e parimeve bashkëkohore demokratike në veprimtarinë e tyre".

Avokati i Popullit: Të gjithë studentët të barabartë!

Në një ligjëratë me studentët e AAB-së në temën "Të drejtat dhe liritë e njeriut", Avokati i Popullit, Sami Kurteshi ka folur për institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, historikun e tij, bashkëpunimin që e ka ky institucion me institucionet simotra të ombudsmenëve të rajonit dhe të Evropës, organizatave në të cilat është anëtare si dhe për rolin e saj në Kosovë. Një ndër çështjet kryesore të shtruara në pjesën debatuese me studentët, Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi, ka folur për trajtimin e studentëve të institucioneve publike e private në Kosovë, me ç' rast tha se të gjithë studentët që kanë përfunduar studimet e tyre në një institucion privat të akredituar me ligjet e Republikës së Kosovës, nuk ka arsye të trajtohen më ndryshe me ata që kanë përfunduar studimet në një institucion publik. "Absolutisht nuk duhet të ketë asnjë dallim tjetër përveç dallimit që bëhet sipas ligjit, në qoftë se ka ndonjë dallim të tillë. Për çdo diskriminim negativ, apo pozitiv, ne do të bëjmë çmos që ta ndalojmë", theksoi Kurteshi. Kurteshi ka komentuar edhe situatën e krijuar së fundmi, në lidhje me kërkesën për regjistrim në Universitetin Publik të studentëve dhe familjarëve të OVL të UÇK-së, duke bërë me dije se kanë filluar hetimet nga ana e institucionit që ai drejton në lidhje me këtë rast,

dhe se ka kërkuar nga Qeveria në detyrë dhe MASHT, që të pezullojnë këtë vendim. "Çdo ndërhyrje nga jashtë që nuk është e ligjshme në punën e çdo universiteti, qoftë privat apo edhe publik, është e pa tolerueshme", ka thënë Kurteshi. Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, ka folur edhe për gjendjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të personave me aftësi të kufizuar, por edhe të komuniteti LGBT. Institucioni i Avokatit të Popullit, përpiqet të jetë aktiv në këtë drejtim, dhe se ka edhe departamentin që merret vetëm me këto çështje, por që ende nuk është i kënaqur me punën që po bëhet në këtë drejtim, ka thënë Kurteshi. Ai ka thënë se në këtë drejtim, duhet të ndryshojë qasja jonë karshi këtyre komuniteteve: "Mendoj se në këtë drejtim ata si grup dhe ne si shoqëri e kemi një problem shumë të madh. Sjellja e institucioneve nuk mund të jetë tjetër se sjellja e shoqërisë", ka thënë ai. Avokati i Popullit të Kosovës, ka folur edhe për zhvillimet politike në vend, duke theksuar se vonesat në krijimin e institucioneve janë çështje politike, por që janë pasojë e votës së qytetarëve. "Të gjithë jemi të shqetësuar me këtë gjendje. Presim me padurim krijimin e institucioneve. Megjithatë është kjo sjellje e partive politike, është pasojë e votës sonë. Nuk mendoj se është ndonjë diskriminim, por është një devalvim i politikës", ka vlerësuar Kurteshi. Gjatë vizitës së tij në AAB, Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi, u prit nga rektori i AAB-së, prof. dr. Lulëzim Tafa, nga i cili u njoftua me zhvillimet e këtij institucioni, që nga fillimi i punës, proceset e deri në ditët e sotme, si dhe është biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën akademike, shkencore dhe atë hulumtuese. Në fund të vizitës, z. Kurteshi u shpreh i kënaqur me të arrituratë dhe punën që bëhet në këtë institucion të arsimit të lartë.

Në AAB u mbajt tryeza "Përparësitë e gazetarisë online përballë mediave tradicionale"

Fakulteti i Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë i Universitetit AAB, mbajti sot një tryezë në temën "Përparësitë e gazetarisë online përballë mediave tradicionale", ku të ftuar krahas stafit mësimdhënës e studentëve ishin përfaqësues të medieve online dhe medieve të reja. Diskutimet u përqendruan në rolin, dallimet dhe përparësitë e mediave tradicionale dhe atyre online si në sfidat me të cilat po përballen këto media, me qëllimi që studentët të informohen përtëardhmen e gazetarisë, për shqetësimet e tyre lidhur me cilësinë e lajmeve apo informacioneve që plasohen dhe çështje të tjera që u diskutuan në këtë debat. Duke u ndërlidhur me temën e diskutimit, Zija Rexhepi, ligjërues në Fakultetin e Komunikimit Masiv, tha se rënia e lexueshmërisë dhe shitjes së gazetave ka ardhur si pasojë e zhvillimit teknologjik dhe përhapjes së mundësisë që përmes internetit si kanal komunikimi, të krijohen mediat e reja, ku një nga to janë edhe portalet ose mediat online. Megjithatë, ardhjen e këtyre mediave, nuk duhet ta shohim si kërcënim për zhdukjen e mediave tradicionale, sepse pavarësisht ardhjes së formave të reja, ato të vjetrat kanë mbijetuar. P.sh. teatri nuk u zhduk me lindjen e filmit, apo gazeta me ardhjen e radios dhe as radio me ardhjen e televizionit, ka thënë Rexhepi. Edhe gazetaria e printuar nuk e ka fundin këtu, është e nevojshme që

ajo të profilizohet, duhet një profilizimi pak më i thelluar. Sipas një studimi rreth 74 përqind e konsumatorëve mediatik informohen nga mediat online në Kosovë, por në këtë përqindje nuk përfshihen të gjitha grupmoshat, përfshihen vetëm moshat e re, theksoi ai, duke shtuar se megjithatë , dilema është se çfarë lajme prodhojnë këto media online dhe se si duhet t' i qasemi atyre. Nga ana tjetër, kryeredaktori i portalit informativ, gazetaexpress.com, z. Leonard Kërquku, dha detaje të hollësishme pse kanë vendosur të kalojnë në versionin online të këtij mediumi, duke marrë edhe shembuj konkretë për shitjen dhe lexueshmërinë e gazetave të shkruara në vend dhe rajon. "Pas vitit 2008, duke e parë trendin e medieve online dhe rënien e shtypit të shkruar çdo ditë shifrat ulen. Sot të gjitha mediat e shkruara nuk shes-

in më shumë se 5 ose 6 mijë kopje në ditë, që është një gjë jo e mirë, përderisa në rajon janë shifrat më të dukshme p.sh gazeta "Blic" i shet jo më shumë se 100 mijë kopje në ditë", tha Kërçuku. Ai vlerësoi se vendimi për të kaluar në versionin online të gazetaexpress, ka qenë hap strategjik, i menduar mirë nga ana e menaxhmentit të këtij mediumi, Kërçuku, shtoi se edhe pse e kanë mbyllur edicionin e shtypur të gazetës, në vazhdimësi e kanëruajtur bërthamën e saj, dhe se i njëjti staf vazhdon të jetë i angazhuar. "Jemi prej portaleve më të mëdha në Ballkan, por kemi arritur shifrën në 1 milion vizitorë, që është një shifër e lakmueshme, shifra që nuk e marrim çdo ditë, por brenda ditës arrijmë deri në 500 mijë, dhe express-i ka arritur të bëhet edhe mëi këndshëm për biznese", përfundoi z. Kërquku. Ndërsa,kryeredaktori i Portalit Informativ, Indeksonline.com, z. Besnik Batusha tha se mediat online e kanë parë përparësinë e plotësimit të lajmit në krahasim me mediat e shtypura, sepse po të botohet një lajm në gazetë apo revistë, ai nuk ka mundësi më që të plotësohet, derisa plotësimi një ditë më pas nuk e ka efektin e kërkuar. Batusha foli edhe për dilemat e vërtetësisë së lajmeve që publikohen në portale, dhe tha se kjo ka ardhur si pasojë e një tregu kaotik në këtë fushë dhe mospasjes së një kodi etik apo kodi të mirësjelljes vetëm për portalet. "Sot portal mund të hap kush të dojë dhe të bëjë çfarë të dojë me të, pa u penguar fare dhe pa u ditur se kush qëndron pas tij apo duke mos pasur fare adresë. Batusha theksoi se në Kosovë, portali zë vendin e parë sa i përket informimit te opinioni publik. Edhe pse nuk ka një shifër të saktë të matjes së diskursit publik, vet fakti i rritjes së lexueshmërisë në portale e arsyeton këtë epitet, të paktën në Kosovë. Pse po ndodh kjo? Kjo po ndodh për disa arsye, duke filluar nga pasojat e pushtimit të gjatë të Serbisë e deri te përhapja masive e teknologjisë", tha ai. Edhe kryeredaktori i Gazetës ditore "Tribuna" dhe i portalit "gazetatribuna.com", z. Arben Ahmeti, shprehu bindjen se kjo fazë e zhvillimit të medias, nuk paraqet fundin e medias së shtypur. Ky lloj trendi i kalimit online është gjithkund në botë, tha Ahmeti. "A po përfundojnë gazetat, jo, harrojeni idenë se nuk do të ekzistojnë më gazetat. Ka pesë dekada që diskutohet nëse do të zhduket libri? Këto lloj mediash mundtë ndryshojnë formë, pozicion, por nuk është rrezik që të shuhet gazeta, ndërsa transformimin që po ndodh unë e shoh në rolin e gazetës", theksoi Ahmeti.
Ai vlerësoi se gazetat kanë rol të rëndësishëm në vendosjen e agjendave mediatike, duke theksuar se lufta kryesore zhvillohet mes komunitetit mediatik dhe grupeve tjera në mes pushteteve, se kushdo t' i bëjë njerëzit të flasin në kafe, dhe se për çka.""Ka ardhur koha që gazetat të rishikojnë pozicionin e vet në treg", tha Ahmeti, i cili mori shembuj nga shtypi në botën me ekonomi të zhvilluara dhe profilizimin e tyre. Në debat morën pjesë edhe shumë studentë të fakultete të cekuar si më lartë të cilët diskutuan dhe të cilët dhanë vlerësime të ndryshme, nga ato online, të cilat po i lexojnë në baza ditore.

AAB nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me FDH në Kosovë

Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, dekani i Fakulteti Juridik në AAB, prof. dr. Muhamet Kelmendi, dhe drejtori i Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDH), Bekim Blakaj nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është që studentët e Fakultetit Juridik të AAB-së të mbarojnë praktikën në FDH, si dhe të kenë qasje në dokumentacionin, monitorim të seancave gjyqësore në gjithë territorin e Kosovës, ligjërata të ndryshme për krime lufte, terrorizëm, viktima etj. "Ky është vetëm hapi ynë i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë ndërinstitucional", ka thënë z. Kelmendi, pas nënshkrimit të marrëveshjes në fjalë.

Ambasadori Vodopija: Me eksod masiv nuk ka perspektivë liberalizimi i vizave

Kroacia është lobues i Kosovës në çdo organizëm ndërkombëtar. Pranimi i Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar është edhe kontribut i Kroacisë. Kështu tha ambasadori kroat në Prishtinë Zoran Vodopija në ligjëratën e tij "Politika e jashtme kroate" të mbajtur për studentët e AAB-së, në Prishtinë.

Profesori Nexhmedin Spahiu i cili ishte nikoqir i ambasadorit tha se Kroacia, Kosova e Shqipëria janë aleatë të natyrshëm dhe mund të mësojnë nga njëri tjetri, prandaj pikërisht kjo është arsyeja përse politikën e jashtme kroate e kam përzgjedhur si model për kursin e lëndës.

Ambasadori Vodopija tregoi për zanafillën e lëvizjes kombëtare kroate dhe krijimin e kombit kroat, për aleatët e tij të natyrshëm dhe për sfidat e politikës së jashtme kroate. Ai përmendi faktin se nga të gjitha vendet ku Serbia pretendon influencën e saj politike, ekonomike e ushtarake (vendet e ish Jugosllavisë minus Sllovenine plus Shqipërinë), Kroacia është i vetmi komb anëtar i Bashkimit Evropian. Ndër sfidat e politikës së jashtme kroate ai përmendi edhe ndikimin në rritje e sipër të Turqisë dhe Rusisë. Ambasadori Vodopija tha se Rusia ka ndikim të madh në Serbi për shkak të lidhjeve tradicionale, por nuk është pa ndikim edhe në vendet e tjera të rajonit. Rusia ka blerë gjysmën e Malit të Zi, ka ndikim të fuqishëm në pjesën serbe të Bosnjës dhe në Maqedoni, dhe po mundohet që të jetë prezente edhe në Kroaci në industrinë e naftës dhe në banka. Ambasadori Vodopija foli edhe për raportet Kroaci-Kosovë duke theksuar natyrshmërinë e raporteve kroato-shqiptare e kroato-kosovare duke shtuar se ka qenë autor i mendimit të ekspertëve që i është ofruar qeverisë kroate për njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe lobimin që Kroacia ka bërë për pranimin e Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe pranimin si vëzhguese në Organizatën e Frankofonisë. Duke folur për lobimin kroat për pranimin në organizmat evropianë, ambasadori Vodopija tha se Kosova duhet të ndjekë rrugën kroate: së pari do të pranohet në Këshillin e Evropës, pastaj në OSBE, më pas në NATO dhe më në fund në Bashkimin Evropian. Por të gjitha këto hapa po i ngadalëson eksodi masiv i qytetarëve të Kosovës, i cili duhet ta shqetësojë më tepër klasën politike dhe mediat e vendit.

Ambasadori Vodopija , ka takuar edhe menaxhmentin e lartë të AAB-së, me të cilët ka biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit në fushën akademike, shkencore dhe atë kulturore. Në fund të vizitës, z. Vodopija u shpreh i kënaqur më të arriturat dhe punën që bëhet në këtë institucion të arsimit të lartë.

Studentët e Fakultetit Juridik të AAB-së në vizitë studimore në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Studentët e Fakultetit Juridik në AAB, kanë zhvilluar një vizitë studimore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe u njohën me rolin dhe kompetencat e çdo funksioni të rëndësishëm në këtë institucion, historinë e funksionimit që nga fillimi i punës së këtij institucioni deri në ditën e sotme.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me procedurat dhe mbarëvajtjen e një seance të hapur publike në fushën civile, që kishte në shqyrtim rastin për kompensim të dëmit, dhe një seancë kryesore për çështje civile të kontestit pronësor, ndërmjet palëve. Nga ana e studentëve u shtrua çështja e mundësisë së bashkëpunimit ndërmjet AAB-së dhe Gjykatës Themelore, për mbështetje praktike. Palët pritëse përkrahën iniciativën dhe shprehën gatishmëri, duke premtuar se edhe në të ardhmen studentët në këto institucione mund të qasen për vizita, hulumtime shkencore etj.

U mbajt ligjërata për procedurat e hartimit të legjislacionit

"Procedurat e hartimit të legjislacionit në Republikën e Kosovës", ishte tema për të cilën para studentëve të vitit të parë Master, të Fakultetit Ekonomik, ligjëroi drejtori i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), të Republikës së Kosovës, Isni Kryeziu. Gjatë kësaj ligjërate, studentët në bazë të njohurive të fituara nga shpjegimi i z. Kryeziut, arritën të hartojnë nga një projektligj dhe projekt udhëzim administrativ për sektorët e caktuar. z. Kryeziu u nda i kënaqur me prezantimet e studentëve, qasjen dhe përkushtimin e tyre ndaj studime dhe profesionit që kanë zgjedhur. Studentët, përveç që u ndanë të kënaqur më ligjëratën e z. Kryeziu, ata përfituan njohuri të reja nga fusha e legjislacionit, dhe rekomanduan që ligjërata të tilla profesionale, të organizohen edhe nëpër lëndë tjera që studiohen në kuadër të programit të tyre.

U mbajt punëtoria për implementimin e strukturës së re të menaxhimit në AAB

Në kalendarin e aktiviteteve të AAB-së, një vend të rëndësishëm kanë edhe punëtoritë dhe trajnimet e ndryshme për rritjen e kapaciteteve të stafit. Pesëdhjetë e tetë zyrtar të lartë dhe menaxherë sektorial të AAB-së, në ambientet e hotelit"Sharr" në Prevallë zhvilluan një punëtori njëditore për aftësimin e personelit. Punëtoria u zhvillua në kuadër të programit për implementimin e strukturës së re menaxhuese në nivel të fakulteteve në AAB. Në pjesën e paradites, pjesëmarrësit punuan në pesë seanca paralele tematike sipas strukturës së re në të cilat u diskutua përkatësisht për cilësinë, shkencën,projektet hulumtuese, mentorimin e punës praktike dhe aktivitetet studentore. Në seancën e pasdites u diskutua a kryesisht për platformën e re online dhe rolin e dekanëve në strukturën e re. Në këtë punëtori u diskutuan gjithashtu rolet e reja, format e përkrahjes dhe u hartuan planet e veprimit për implementimin e strukturës së re. Njëkohësisht, të gjitha grupet diskutuan aktivitetet që do të përkrahen gjatë gjashtë muajve në vijim në implementim të strukturës së re dhe të planit strategjik të AAB-së për vitin 2015.

Në mbyllje të punëtorisë rektori Lulëzim Tafa, përsëriti përkushtimin e rektoratit dhe premtoi përkrahje të vazhdueshme për zhvillimin profesional të personelit dhe për avancimin e pandërprerë teknologjik e menaxherial të AAB-së.

Vlerësimi i stafit akademik nga studentët

Në prag të përfundimit të semestrit dimëror 2014/15, do të fillojë vlerësimi i stafit akademik nga ana e studentëve si pjesë e procesit të vlerësimit të brendshëm që realizohet në fund të secilit semestër akademik. Ky vlerësim do të ndihmojë në zgjerimin e programeve dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në Kolegjin AAB. Vlerësimet e studentëve do t' i ofrojnë informata të rëndësishme Zyres për Sigurimin e Cilësisë, të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e kuadrit akademik dhe lëndëve që ofrojmë. Gjithashtu, ky vlerësim do të ndihmojnë në përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve akademike dhe administrative me në qendër studentin. Si gjithmonë, vlerësimi i stafit akademik nga ana e studentëve do të realizohet përmes sistemit elektronik, e-service, në kuadër të paraqitjes së provimeve për afatin e janarit 2014/15, dhe është plotësisht anonim.

Institucioni i Arsimit UNIVERSITAR AAB
PRISHTINË
Zyra për Sigurimin e Cilësisë

PYETËSORËT ONLINE

NDAJE MENDIMIN TËND!

Erdhi koha për të dhënë mendimin tuaj!

Ky vlerësim do të ndihmojë në zgjerimin e programeve dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në Kolegjin AAB. Vlerësimet e Juaja do të na ofrojnë informata të rëndësishme të cilat do të na ndihmojnë në përmirësimin e kuadrit akademik dhe lëndëve që ofrojmë. Gjithashtu, do të na ndihmojnë në përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve akademike dhe administrative me në qendër studentin.

Vlerësimet e juaja janë plotësisht anonime

Para se të mund të bëni paraqitjen e provimit në një lëndë për afatin e Janarit, Ju duhet të plotësoni një pyetësor online në lidhje me profesorin dhe asistentin e lëndës dhe cilësinë e shërbimeve studentore. Për Zyrën e Sigurimit të Cilësisë është shumë e rëndësishme që të marrim mendimin tuaj për profesorët dhe cilësinë e paraqitjes së tyre. Andaj, ju lutem ndani disa minuta për ne. Pyetësori do të shfaqet te ju në menyrë të rastësishme gjatë paraqitjes së provimeve.





Mendimet tuaja të sinqerta kontribuojnë në:

- Përmirësimin e mënyrës së ligjërimit nga profesorët dhe në përmirësimin e ushtrimeve
- Evidentimin e pakënaqësive të studentëve në lidhje me profesorin dhe asistentin në një lëndë
- Mënyrën e vlerësimit të studentëve nga profesori
- Kuptimin e gjërave që studentëve iu pelqen
- Eliminimin e parregullsive në procesin akademik
- Përmirësime në shërbimet administrative, shërbimet studentore dhe në infrastrukturë

Kontribuo në përmirësimin e procesit akademik

Mendimi Juaj i dhënë është plotësisht ANONIM dhe shërben për përmirësim të Universitetit tonë, ku në qendër të vëmendjes është studenti.

Urimet e stafit menaxherial të AAB-së për Vitin e Ri 2015

Lulëzim Tafa, Rektor

"Mund të themi se për AAB-në viti 2014 ishte vit i sukseseve. Është e pamundur të numërohen të gjitha. Mendoj se interesimi i jashtëzakonshëm i të rinjve të Kosovës për t' u bërë pjesë e AAB-së flet më së miri për emrin dhe reputacionin që AAB-ja ka në fushën e arsimit të lartë në Kosovë. Po ashtu ne kemi filluar mësimin edhe në gjuhën e komuniteteve dhe jemi ndër institucionet e rralla jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë që mbajmë mësim në tri gjuhë. Viti 2014 për AAB-në krahas numrit prej mbi 6000 studentëve të rinj, të regjistruar sivjet, është edhe avancimi i stafit të ri akademik, sidomos e një pjesë tëmadhe të asistentëve dhe ligjëruesve të rinj, disa prej të cilëve i kanë përfunduar studimet e doktoratës, disa janë në vazhdim e sipër, ndërsa një numër po ashtu i madh i tyre sivjet i kanë regjistruar studimet e doktoratës kryesisht në universitete jashtë Kosovës. Edhe intensifikimi i punës kërkimore-shkencore në universitet, por edhe bashkëpunimi ndërkombëtar, janë suksese që na bëjnë krenarë për të arriturat në vitin që po e lëmë pas. Po ashtu edhe te pjesa e infrastrukturës është punuar mjaft, është duke u përfunduar projekti ndërtimor i hapësirave të reja mësimore,që këto ditë do tëfillojë të ndërtohet, tek Kampusi i AAB-së që do të njihet si objekti 7 apo shtatëshi, e që do të jetë objekti më i madh në kampusin tonë (mos të harrojmë se objektet 5 dhe 6 gjenden në Ferizaj dhe Gjakovë) ky objekt do të jetë i pajisur me salla moderne të mësimit, laboratorë, hapësira administrative, ambiente relaksuese, salla sportive, por edhe ambiente kulturore si teatër, galeri etj. Uroj studentët në radhë të parë, por edhe profesorët dhe të gjithë kolegët dhe bashkëpunëtorët, që këto suksese së bashku të na përcjellin edhe në vitin 2015", uron në fund rektori LulëzimTafa.

Shemsedin Vehapi,
zv. Rektor/ Prorektor për Çështje Mësimore

Xhavit Rexhaj,
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Sukseset e departamentit tim kanë qenë sukseset e tërë universitetit. Kjo sepse nuk ka marrëdhënie të suksesshme me jashtë pa një organizim të mirë të brendshëm dhe pa një organizatë të fuqishme. Rrjedhimisht, suksese të departamentit tonë i konsiderojmë fillimin e punës së programit në gjuhën boshnjake, rritjen e numrit të mësimdhënësve në AAB, rritjen e numrit të studentëve, avancimet e cilësisë dhe veprimet vendimtare në drejtim të forcimit të hulumtimeve shkencore.
Në kuptimin më të ngushtë, suksese janë pjesëmarrja në Konferencën IEAI Prague 2014, për ndërkombëtarizimin e Arsimit të Lartë, nënshkrimin e rreth 15 marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione vendore e ndërkombëtare, anëtarësimin në rrjetin e Universiteteve të Adriatikut UNET organizuar nga Universiteti Primorska i Sllovenisë, hapat e parë të depërtimit në tregun turk të arsimit të lartë, kontaktet për partneritete me institucione austriake e evropiane për hartimin e projekteve "ErasmusMundus" të Komisionit Evropian, etj..
Një element tjetër shumë inkurajues është se këtë vit kemi shtatë ftesa për pjesëmarrje në projekte "ErasmusMundus" të Komisionit Evropian, që na vijnë nga institucione të njohura nga Evropa dhe rajoni. Kjo është shumë me rëndësi sidomos për faktin se sapo ka dalë thirrja për projekte "ErasmusMundus". AAB-ja planifikon të konkurrojë më së paku në tri projekte si partner kryesor dhe në pesë si përfituese. Prioritet për vitin e ardhshëm mbetet rritja e mobilitetit të studentëve e të personelit si nga burime evropiane dhe nga mjetet vetanake të AAB-së.

"Në vitin që lamë pas AAB-ja ka vazhduar me përmirësimin e cilësisë në aspektin akademik në të gjithë institucionin. Ndër të arriturat kryesore që mund të llogariten janë, përveç riakreditimit për afatin pesëvjeçar të programeve nga fusha e Administratës Publike, Përkujdesjes dhe Mirëqenies së Fëmijëve dhe Gjuhës Angleze edhe akreditimi për herë të parë i Programit"Dizajni i Modës" në nivelin bachelor dhe "Menaxhimi Sektorial" në nivelin master. E veçanta e këtij viti është edhe hapja e mundësisë për studim në gjuhë boshnjake në Programet Juridike.

Cilësia e implementimi të programeve mësimore, avancimi i metodologjisë së mësimdhënies dhe përmirësimi i kushteve të punës kanë qenë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme.

Gëzuar 2015! Shëndeti, mbarësia gëzimi dhe lumturia ju përcjellshin gjatë gjithë vitit. Suksese!", uron prorektori Vehapi.

Zija Rexhepi,
Prorektor për Administratë

"Në vitin që po lëmë pas, në AAB sukseset janë evidente në të gjitha sferat. Mund të ndihemi të plotësuar me suksesin e përmbylljes së vitit akademik që e lamë pas, dhe me përgatitjet që kemi bërë për vitin akademik të cilin e kemi filluar në tetor 2014. Kemi qenë në krye të detyrës dhe shërbimit për studentët dhe jemi të lumtur që po e përmbyllim edhe këtë vit kalendarik sipas planifikimeve të bëra më herët.Urimi im për Vitin e Ri: Para së gjithash, shëndet të plotë për të gjithë studentët, stafin punonjës dhe familjet e tyre! Uroj që Viti i Ri 2015, të sjellë shumë të mira, suksese e begati për të gjithë! Gëzuar!", thotë Rexhepi.

Granit Curri,
sekretar

Sukseset që do të përmendja unë për dallim prej vitit të kaluar janë shumë më të mëdha dhe konkrete, që reflektohen në rritjen e llogaridhënies, kontrollit të brendshëm, ngritjes së kapaciteteve të administratës, avancimit të sistemit të të dhënave, zhvillimit të programeve të reja.
"Po ashtu si sukses në këtë vit do ta veçoja avancimin e stafit akademik në thirrje akademike duke filluar prej gradës së ligjëruesit deri tek profesori i asociuar. Ky ka qenë një proces me shumë interes për stafin akademik, këtë e bazoj në numrin e aplikuesve dhe të interesuarve për konkursin e ardhshëm.
Po ashtu vlen të përmendet edhe procesi i akreditimit, i cili në fund ka rezultuar me riakreditimin e programeve dhe akreditimin e programit të ri Menaxhimi Sektoriale- master.Sukses do ta veçoja edhe pasurimin e infrastrukturës ligjore me disa rregullore të reja, të cilat kanë ndikuar në efikasitetin e shërbimeve: Rregullorja për studime të doktoratës;Rregullorja për komunikim të brendshëm; Rregullorja për kalendarin e aktiviteteve të rregullta vjetore. Është e pamundur që suksesin e sektorit tim ta ndaj nga sektorët tjerë për shkak të bashkëpunimit dhe ndërlidhshmërisë sëpunëve dhe është shumë e vështirë ta përmbledhësh me një shkrim gjithë punën dhe aktivitetet ditore, javore e mujore.

Stafit akademik, administrativ dhe teknik ju uroj vitin e ri 2015. Urim të veçantë për studentët e AAB-së, ju uroj një vit të mbarë, suksese në studime, e sidomos atyre që kanë diplomuar ju uroj punësim sa më të shpejt., thotë Granit Curri, sekretar.

Vjollca Hasani,
dekane – Fakulteti Ekonomik

Fakulteti Ekonomik është vet suksesi i AAB-së, edhe këtë vit ishte i pari ndër fakultetet tjera, për nga numri i programeve që ofron, numrin e studentëve të regjistruar dhe stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie!
Poashtu si rezultat i punës sonë, kemi arritur të fitojmë besimin e studentëve tanë të diplomuar në bachelor që ata tutje, të vazhdojnë tek ne, studimet në programet master. Ajo që e bën këtëfakultet të ndihet krenar për sukseset e veta është edhe mirënjohja e ndarë, dekanes dhe stafit përcjellës akademik të saj, për punën dhe mbështetjen e vazhdueshme nga studentët e gjeneratës 2009-2014, të përcjellur në dy programet bachelor dhe master.
Studentëve tani do t'ju përcillja një mesazh: duke qenë tani pjesë e Universitetit AAB, jeni duke përgatitur veten për një maratonë që do të fillojë pasi të keni diplomuar. Andaj përqëndrohuni në qëllimet tuaja në studime, që të arrini cakun sa më shpejt dhe sa më të përgatitur: Uroj përzemërsisht, të jetë viti 2015 vit suksesi për të gjithë ju!
Ndërkaq për kolegët dhe miqtë e mi të dashur, po ju drejtoj këtë urim duke ju treguar se sa e nderuar jam të punoj me ju në këtë institucion prestigjioz, sa krenare ndihem për sukseset që i arritëm bashkërisht dhe uroj që viti 2015 të jetë një vit i mbarë me shëndet dhe shumë gëzime për të gjithë ne!
Gëzuar 2015!, thotë dekanja Hasani.

Vehbi Miftari,
dekan Fakulteti i Shkencave Social

Viti 2014 ka qenë vit i konsolidimit të mëtejmë të Fakultetit të Shkencave Sociale, qoftë përsa i takon procesit mësimor, qoftë atij kërkimor. Kemi riakredituar programin në studimet themelore për pesë vjet të tjera, si dhe atë në master për tri vjetët e ardhshme. Janë konsoliduar programet mësimore dhe programet e lëndëve. Po kështu, është intensifikuar bashkëpunimi me studentët, duke u ofruar mundësi shtesë të komunikimit me stafin akademik e administrativ, janë zgjeruar shërbimet për ta, si dhe u është mundësuar qasje më e lehtë në informata dhe në materialet mësimore. Në bashkëpunim me stafin akademik, janë zgjeruar mundësitë e ndërlidhjes së pjesës teorike me atë praktike, duke e shtrirë bashkëpunimin në institucione dhe organizata që merren me mirëqenien dhe edukimin e fëmijëve. Tashmë, në kuadër të lëndëve janë hartuar disa projekte kërkimore, ndërsa po punojmë në dizajnimin e tri projekteve të mëdha hulumtuese, të cilat prekin përfshirjen, standardet e edukimit parashkollor dhe koncepteve bashkëkohore për arsimin parashkollor. Këto projekte mëtojmë t'i realizojmë në bashkëpunim me Zyrën e sapothemeluar të Projekteve gjatë viti të ardhshëm. Studentëve, stafit akademik dhe të gjithë kolegëve të AAB-së, u uroj të kenë shëndet të mirë dhe t'u prijë e mbara!



Petrit Bushi,
dekan – Fakulteti i Administratës Publike

Viti 2015, Fakultetin e Administratës Publike në AAB, e gjen me rezultate konkrete dhe ambicie për prioritetet tona. Energjia, dëshira dhe vullneti i studentëve dhe nga ana tjetër etja për dije, informacion dhe njohje kanë qenë parakushtet e pashmangshme për t`u përqasur në anën e vlerave dhe të zhvillimit. Vullneti i pathyeshëm i kombinuar me dijen dhe urtësinë është formula që garanton sukses, na mëson historia.
Fakulteti i Administratës Publike, pa realizuar tashmë të gjitha objektivat e parapara në programet e tij, program cilësish të lartë dhe bashkëkohor, në të dyja profilet, Administratë Publike e Shkenca Politike dhe Diplomaci, me dy nivele të studimit BACHELOR dhe MASTER, i akredituar deri në 2019-ën, me mbi 2000 studentë, me ambiente dhe kushte studimi ndër më të mirat në rajon, me shërbim administrativ të standardeve të larta, me staf mësimdhënësish të profilizuar sipas fushave në Universitetet më të mira të Evropës, dhe të gjitha këto falë menaxhmentit të AAB, i cili në çdo moment, kanë fokusin e tij shërbimin për STUDENTIN.
Të vetëdijshëm për rëndësinë e rrugës që kemi nisur, i shtrijmë dorën e bashkëpunimit çdo studenti që jeton me shqetësimet e kohës së tij, që është i ndërgjegjshëm për rolin që duhet të luajnë një shoqëri, që përpiqet të rimodelojë veten sipas parimeve dhe vlerave më të larta njerëzore.
Në përfundim të këtij mesazhi urojme që çdo përpjekje e bërë gjatë vitit që kaloi, çdo natë pa gjumë e kaluar mbi libra të jetë lajmëtare e suksesit dhe dëshmi e realizimit të vlerave.

Muhamet Kelmendi,
dekan - Fakulteti Juridik

Vitin e ri akademik 2014/2015 e filluam me një entuziazëm të theksuar. Sukseset e vitit paraprak treguan për një angazhim të thelluar të studentëve dhe të profesorëve në nxënien e dijes shkencore. Entuziazmi i tillë vazhdoi këtë vit nga të gjithë akterët e studimeve bachelor dhe master. U arrit që ky vit të jetë viti i angazhimeve të mëdha në studime. Patëm regjistrim rekord në studime dhe arritëm që të kemi stafin akademik më të kualifikuar në rreth. Ne e kishim një kalueshmëri jashtëzakonisht të suksesshme. Mbi këtë presim një vit të ri shumë të avancuar në nxënien e dijes dhe të studimeve shkencore. Të gjitha mundësitë i kemi. Ne posedojmë me kuadro dhe me interesim të madh të studentëve për mësim e studim individual dhe grupor.Me ndihmën e stafit do të arrijmë pretendimet tona studimore.
Në emër të Dekanatit të Fakultetit Juridik ju uroj suksese në vitin 2015.
Dëshiroj shëndet dhe studime të suksesshme, uron dekani Kelmendi.

Venera Llunji,
dekane – Fakulteti i Gjuhës Angleze

Vullneti dhe gatishmëria për të ofruar më të mirën për studentët, suksesi i tyre i treguar gjatë vitit, shpirti bashkëpunues, përmbushja e obligimeve dhe e përgjegjësive nga të gjithë kanë bërë që ky vit të jetë sa sfidues aq edhe i mbarë,i suksesshëm dhe i këndshëm për Fakultetin e Gjuhës Angleze në AAB.
Të gjithë studentëve, kolegëve dhe miqve, ju dëshiroj një Vit te Ri plot gëzim, hare, lumturi e shëndet", uron dekanja Llunji.

Mehdi Jashari,
dekan -Fakulteti i KulturësFizike dhe Sportit

Viti akademik 2014/2015 mund të veçohet si viti më i suksesshëm deri më tani sa i përket rritjes së numrit të studentëve të regjistruar, të cilët janë joshur për të studiuar në tëdyja nivelet e studimit. Urimet për festat e fundvitit i shkojnë studentëve, stafit akademik duke uruar që të vazhdojnë një bashkëpunim të ngushtë dhe reciprok për nxënien e njohurive më të rëndësishme në profesionin e zgjedhur, uron dekani Jashari.

Hasan Saliu,
dekan - Fakultetit i Komunikimit Masiv

Një vit i sukseseve
Të dashur studentë!
E përmbyllëm edhe një vit kalendarik, një vit pune e përpjekjesh të vazhdueshme. Në Fakultetin e Komunikimit Masiv është punuar në drejtimet e Gazetarisë e Produksionit si dhe në Master në Komunikim masiv. Sukseset nuk kanë munguar pikërisht në saje të angazhimit Tuaj, përkushtimit të stafit tonë si dhe kushteve që keni ju në mjediset e AAB-së. Për këto kushte, më besoni, ua kanë zilinë studentët e rajonit. Fati ju ka buzëqeshur që Ju të punoni sot këtu për një të nesërme më të mirë. Jo vetëm për veten Tuaj, por për një të nesërme më të mirë për shoqërinë e Kosovës. Jeni ju gazetarët dhe regjistruesit e ardhshëm të realitetit shoqëror që ta përparoni më shumë këtë shoqëri, jeni Ju kontrolluesit e përditshëm të demokracisë dhe nxitësit e progresit.
Por, të mos harrojmë se ky vit që erdhi tani, do të kalojë sërish pas një viti. Kjo na bën që të mos i japim kohës aq shumë kohë, sepse tjetri vjen sërish, kur ne i bëjmë bilancet tona. Të punojmë përditshëm që e nesërmja të jetë më e ndritur.
Të dashur studentë, duke përmbyllur një vit suksesi, ju rinisni një nivel të ri suksesesh. Në këtë rrugëtim të sigurt Ju keni të gjithë të drejtën e botës që t'u gëzoheni arritjeve të deritanishme. Andaj i bashkohem këtij gëzimi për t'Ju dëshiruar që ky Vit i Ri të jetë ashtu siç e dëshironi Ju, me realizimin e dëshirave dhe përvojave të reja profesionale; që ky vit t'ju sjellë vetëm gëzim dhe festë suksesesh!

Gëzuar!

Shyqri Nimani,
dekan- Fakulteti i Dizajnit dhe Multimediave

Në mesin e sukseseve të vitit 2014 do të theksoja diplomimin e studentëve të parë me Program të akredituar, arritjen e riakreditimit të Programit tonë të Dizajnit Grafik dhe Multimediave, si dhe akreditimin e Programit tonë për Dizajnin e Modës (Fashion Design). Duhet përmendur edhe botimin e numrit të parë të revistës profesionale të studentëve të Arkitekturës dhe të Dizajnit Grafik dhe Multimediave, ARCH+DES.
Urime të sinqerta për shëndet të mirë, devotshmëri ndaj punës dhe, natyrisht, suksese sa më të larta!

Ermir Rogova,
dekan - Fakultetit i Shkencave Kompjuterike

Studentë të dashur dhe kolegë të nderuar,
Viti që po lëmë pas ka qenë një vit përplot ndryshime për FSHK-në. Në aspektin e mësimdhënies, kemi përzgjedhur stafin më të mirë të mundshëm në rajon. Kemi mësimdhënës që kanë studiuar dhe ligjëruar në institucione me renome botërore.
Në aspektin e konkretizimit mësimor, kemi pajisur tre laboratorë me pajisjet kompjuterike të gjeneratës së fundit dhe me serverë. Në kuadër të kësaj përfshihen edhe pajisjet konkretizuese hardverike si robotët NAO të gjeneratës së fundit, pllakat Arduino, e të tjera. Në aspektin e pajimit me softver të licencuar, kemi arritur që fakultetin tonë ta regjistrojmë në programin Dreamspark, i cili na jep qasje në mbi 200 aplikacione të Microsoft për përdorim të licencuar nga studentët dhe stafi, pa pagesë.Të gjitha këto kanë rezultuar në një ngritje të dukshme në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Viti i kaluar pa dyshim që ka qenë i suksesshëm dhe ju garantoj që viti që vjen do të sjellë edhe më shumë risi të këndshme.
Urime festat e fundvitit! Le të jetë një vit i sukseseve dhe të arriturave të të gjithë neve së bashku!

Jusuf Qarkaxhija,
drejtor i Degës së AAB-së, Gjakovë

Gjatë vitit 2014, në degën e AAB-së në Gjakovë kanë diplomuar studentët e gjeneratës së parë të Fakultetit Ekonomik dhe të Shkencave Sociale, të cilët janë të gatshëm për të zbatuar njohuritë e fituara në tregun e punës. Universiteti AAB në Gjakovë gjatë këtyre tre viteve punë është shndërruar në institucion të nivelit elitar në këtë rajoni dhe ka emër të respektuar të të gjithë spektrit akademik dhe jo akademik në Gjakovë. Duke iu falënderuar emrit të mirë dhe punës së stafit të AAB-së në Gjakovë, studentët tanë janë të mirëpritur kudo gjatë zhvillimit të punës praktike, si në institucione publike (shkolla, çerdhe, kuvendin komunal, spital etj.) ashtu edhe në institucione private. Gjatë vitit 2014 institucionin tonë e kanë vizituar nxënësit e të gjitha shkollave të mesme të Komunës së Gjakovës si dhe shumë personalitete të ndryshme nga vendi dhe jashtë dhe të gjithë kanë mbetur të kënaqur nga ajo që kanë parë. Ne nuk do të ndalemi së punuari dhe do të fokusohemi që studentët tanë të jenë në krye të listave të të punësuarve.
Të gjithë studentëve të AAB-së ju uroj një vit të ri me plot gëzime dhe suksese. Çdo sukses i studentëve është edhe yni, prandaj le ti gëzojmë bashkërisht ato.



Neki Juniku,
dekan - Fakultetiti Psikologjisë

Vitin 2014 e karakterizon rritja evidente dhe afirmimi i fuqishëm i Fakultetit të Psikologjisë, kësaj njësie më të re akademike të AAB-së. Tek studentët hetohet qartë ngritja përgatitore dhe e nivelit të aspiratave studimore. Krahas vijimit shumë të rregullt, aktiv dhe cilësor të ligjëratave, studentët po shfaqin interesim gjithnjë e më të madh për hulumtim shkencor duke manifestuar gatishmërinë për pjesëmarrje kreative në projektet hulumtuese që tanimë janë bërë pjesë e rëndësishme dhe me influencë e këtyre studimeve.
Unë jam i bindur se ky motivim për studim cilësor do të ngritet akoma më shumë. Për tërë këto arritje ndihem krenar me studentët tonë dhe me këtë rast ua dërgoj urimet e mia për vitin e ri 2015, me dëshirën për shëndet, lumturi rinore dhe suksese akoma më të mëdha.
Për këtë sukses e përgëzoj stafin e Fakultetit të Psikologjisë, këtë ekip të ri me shumë ambicie profesionale e shkencore, me aspirata të larta për mësimdhënie të përkushtuar dhe kreative. Me këtë staf shembullor krenohem sot, sikurse jam krenuar edhe kohë më parë, kur ishin studentë të shkëlqyer.
Me këtë rast, nga zemra ua uroj Vitin e Ri 2015, me dëshira të sinqerta për shëndet, jetë të lumtur dhe për suksese akoma më të larta në rritjen e tyre profesionale e shkencore!

Medain Hashani,
drejtor i Degës së AAB–së, Ferizaj

Sa i përket sukseseve në degën e Ferizajt gjatë vitit 2014 , ato janë të shumta, ndërsa do të përmendi disa nga nga ato të cilat po kanëimpakt në sukseset tona në vazhdimësi, si: Memorandumet e nënshkruara me Postën e Kosovës; Drejtorinë për Financa dhe Buxhet; Drejtorinë Komunale të Arsimit; Qendrën rajonale të aftësimit dhe Administratën Tatimore të Kosovës. Në të gjitha këto institucione me të cilat kemi memorandum gjatë tërë vitit studentët e degës së Ferizajt përfundojnë punën praktike, pa asnjë problem ku në të gjitha këto institucione janë vetëm studentët e AAB-së.
Këto janë disa nga sukseset e vitit 2014 të cilat kanë pasur një impakt mjaft të lartë në ngritjen e imazhit të AAB-së në regjionin e Ferizajt.
Ndërsa urimi për të gjithëështë që në vitin 2015, të kemi vazhdimësi të përformancës nga stafi i AAB-së në përgjithësi, që studentët në vitin 2015 të jenë më të angazhuar në projekte konkrete dhe zhvillim ekonomik qëështë duke i munguar vendit tonë, për punësim më të madh të studentëve pas përfundimit të studimeve.
Ju dëshiroj punë të mbarë dhe gjithë të mirat!

“Mendja e shprisht” fitoi çmimin për filmin më të mirë

Në një ceremoni solemne të organizuar në ambientet e AAB, para të pranishmëve si studentë e profesorë të këtij institucioni, u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve kryesore për kategorinë e filmit shkurtër, të punuar nga studentët e vitit të parë, të Fakultetit Komunikim Masiv dhe Gazetari dhe Fakulteti Produksion, në kuadër të lëndës “Hyrje në komunikim”, te profesor Adi Krasta.

Profesori Adi Krasta pasi përshëndeti të pranishmit dhe duke e vlerësuar lart punën e studentëve tha: “Ju keni prodhuar 12 filma të shkurtër, kjo është për t’u krenuar, kurse 14 filma prodhonte Kinostudio “Shqipëria e re” në kohën e Enver Hoxhës, 14 filma të shkurtër prodhonte shteti shqiptar, kurse 12 filma të shkurtër prodhon viti i parë i Universitetit AAB të Fakultetit të Komunikimit”.

Prof. Krasta shtoi se për vlerësimin dhe ndarjen e çmimeve komisioni përzgjedhës pasi i kanë shikuar filmat nga fillimi e deri në fund i kanë ndarë këta fitues: Çmimi për producentin më të mirë, fitues është Artan Avdiu, çmimi aktori më i mirë, fitues është Migjen Cana, çmimi aktorja më e mirë, dorëzuar nga asistenti i lëndës Arbër Geci, fituese është Arlinda Zeqiri, çmimin montazhieri më i mirë e dha Hekuran Krasniqi, fitues është Taulant Haxhisefa, çmimin për fotografinë dhe kamerën më të mirë e dha dekani i Fakultetit Komunikim Masiv dhe Gazetari, HasanSaliu, fitues ishin studentët Nysret Begolli dhe Besart Gashi, çmimi për skenarin më të mirin e dha prorektori për Çështje Mësimore, Shemsedin Vehapi, fitues Enis Murati, çmimi regjisori më i mirë, fitues është Albuena Balaj, dhe çmimin për filmin më të mirë “Mendja e shprishtë”, e dha kryetari i Bordit të Universitetit AAB, prof. Ilir Tafa.

Me një fjalë rasti ceremoninë e ka përshëndetur kryetari Tafa,i cili e vlerësoi punën që po bëhet në Fakultetin e Komunikimit Masiv dhe Produksionit, po ashtu punën dhe studimet që zhvillohen në përgjithësi në AAB, duke theksuar se këto suksese të cilat u prezantuan në këtë ambient ndërlidhen me zhvillimin e kinematografisë të vendit dhe më tej: “Është një kënaqësi shumë e madhe që studentët e vitit të parë të futen në një sistem garues. Jam i mahnitur me punën që kanë realizuar në mënyre kolektive. I përgëzoj studentët fitues që brenda dy muajve, që nga nisja e vitit akademik keni një produkt të cilësisë së tillë, dhe urojmë që çdo vit të shtohet numri i filmave të tillë”.

Të gjithë studentët fitues të çmimeve të përmendura e falënderuan Universitetin AAB, që u ka dhënë mundësinë dhe kushtet nga më të mirat, pastaj stafin e përzgjedhur akademik, dhe profesorin e tyre Adi Krasta. Këta 12 filma të shkurtër nga fillimi deri tek realizimi i tyre u mbështetën nga Universiteti AAB.

Doli libri më i ri “Mediakultura”, i autorit Ibrahim Berisha

Në librin më të ri “Mediakultura” studiuesi Ibrahim Berisha trajton fenomenin kulturë në një marrëdhënie konvergjuese me medien. Në libër shtrohen koncepte dhe interpretime kritike mbi fenomenin maskulturë si dhe efektet e saj sociale. Autori thekson se me gjithë sinonimitetin, termat masskulturë dhe kulturë mediale, në origjinal, anglishte media culture, sa do që në të parë nuk duket, dallojnë mes tyre. Masskultura megjithëse determinohet më shumë nga media, ajo krijohet dhe konsumohet, që para krijimit të shtypit. Por, ajo merr përmasën dhe kuptimin e plotë, vetëm duke qenë pjesë e sistemit të madh që e mundëson teknologjia komunikuese.

Berisha vëren se mundësia për të pasur qasje të lirë në përmbajtjet kulturore ka rritur influencën për rishikime dhe përkufizime për fenomenin kulturë, që kishte qëndruar gjatë e konsoliduar.

Ndër çështjet që ka trajtuar autori, janë shija massive, industria kulturore, masskulura pastaj, teknologjia komunikuese dhe sfera private, globalizimi kulturor, identiteti personal dhe masskultura, reklama dhe masskultura, identifikimi kulturor, mediatizimi dhe feminiteti, libri si - mikro dhe televizioni si - makro model kulturor, komunikimi i dijes në teknologjitë digjitale, arts-imitimi, gjuha e massmedies, artautoriteti politik, përjashtimi dhe glorifikimi.

Libri në fjalë gjendet edhe në Bibliotekën e AAB-së, e cila do të jenë në dispozicion të studentëve dhe stafit të këtij institucioni, për qasje sa më të thellë në botën e shkencës e hulumtimit profesional.

Prof. dr. Ibrahim Berisha, përveç që është profesor në Fakultetin e Komunikimit Masiv në AAB , është studiues, prozator, poet, publicist.

Studentët e arteve festuan festat e fundvitit

Studentët e të të gjitha drejtimeve të Fakultetit të Arteve të AAB-së, organizuan një ndejë për festave të fundvitit.

Në ndejën e organizuar, përveç një numri të madh studentësh, morën pjesë edhe menaxhmenti i lartë i AAB-së, profesorë dhe mysafirë të tjerë.

Ndeja u shoqërua me muzikë nga vetë studentët dhe profesorët e Fakultetit të Muzikologjisë, që krijoi një atmosferë të mirë, të shoqërimit dhe festimit të festave të fundvitit, si dhe nisjes së jetës akademike për studentët e rinj.

U promovua libri "Shqiptarët, diamantet e pagdhendur" i autorit Ylli Polovina

Në një atmosferë të bukur akademike, sot, në Qendrën Mediale Universitare të AAB-së, u bë promovimi i librit "Shqiptarët, diamantet e pagdhendur",i autorit Ylli Polovina.

Me këtë rast, Rektor i AAB-së, prof. dr. Lulzim Tafa, e duke e vlerësuar lart veprimtarinë e shkrimtarit Polovina, ndër të tjera tha:

"Në 14 vjetët e funksionimit tonë, ne kemi promovuar libra edhe të autorëve të shumtë edhe jashtë Kosovës, e sidomos të autorëve nga Republika e Shqipërisë. Në fushën e tregut të librit, AAB ka një treg krejtësisht të unifikuar me Republikën e Shqipërisë, pasi që autorët shqiptarë pa dyshim i kërkojnë lexuesit shqiptarë kudo që janë, qofshin ata në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Luginën e Preshevës dhe gjithandej."

Duke folur për librin "Shqiptarët, diamantet e pagdhendur", autori, Ylli Polovina, tha se libri është ndërtuar duke shkëmbyer opinionet me bashkëkombësit që duan të zbulojnë se çfarë mendësie kanë shqiptarët, cilat karakteristika kryesore të identitetit shfaqin, natyrën psikologjike, temperamentin apo të dhënat antropologjike të tyre.

Ky libër dëshiron të ofrojë ndihmën e vet në njohjen e tij edhe për të gjithë ata të huaj që merren me popullin dhe shtetin tonë, tha Polovina.

Z. Polovina gjithashtu bëri një përmbledhje të të gjithë librave të botuar deri më tani, por më shumë u fokusua tek veprat e botuara me temë për Kosovën.

Ylli Polovina ka lindur në Berat në Republikën e Shqipërisë. Në vitin 1970 i përfundoi studimet në Universitetin e Tiranës, ku u diplomua për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe. Ka punuar si pedagog në shkolla fillore dhe të mesme, si drejtor teatri, kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë. Nga dhjetori 1997 deri në mars 2002 ishte i angazhuar në shërbimin diplomatik i Republikës së Shqipërisë në Itali. Gjithashtu, ka punuar edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë në Tiranë.

Deri tani ka botuar mbi 24 libra, nga to katër libra në gjuhë të huaj.

Prof. dr. Ragip Halili librin "Viktimologjia" ua dhuron studentëve të Juridikut në AAB

Prof. dr. Ragip Halili, studentëve të cilëve ua ligjëron lëndën "Viktimologjia", ua ka dhuruar nga një kopje të librit me të njëjtin titull "Viktimologjia". Libri është ribotim i autorit dhe ka dalë nga shtypi kohëve të fundit.

Studentët me këtë rast, u shprehën tejet të kënaqur se bibliotekat e tyre po pasurohen gjithnjë e më shumë, përfshirë edhe me librin shkencor "Viktimologjia", tejet të nevojshëm për profesionin që kanë zgjedhur ta studiojnë.

"Nevoja për një tekst të këtillë është ndjerë për një kohë të gjatë, prandaj hartimi dhe botimi i këtij teksti plotëson një boshllëk për literaturë dhe material më elementar për përgatitjen e lëndës mësimore 'Viktimologjia'", ka thënë prof. Halili.

Biblioteka e Fakultetit të Gjuhës Angleze në AAB, pasurohet edhe me 50 tituj të rinj - donacion i Dr. Marry Ellen Schminder

Fondi librar i English Corner, që është pjesë përbërëse e Bibliotekës së Fakultetit të Gjuhës Angleze, u pasurua edhe me 50 tituj të rinj, donacion i profesoreshës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Marry Ellen Schminder.Dr. Marry Ellen, tha se me këtë donacion do të mund të përfitojnë studentët e Gjuhës Angleze, të cilët do të kenë mundësinë të mësojnë më shumë për letërsinë multi-kulturore që zhvillohet në SHBA.

Ndërkaq, dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze, Venera Llunji, PhD., me rastin e pranimit të këtij donacioni, falënderoi profesoreshën dr. Mary Ellen Schmider, kurse kujtoi se këta tituj të librave janë me interes për studentët e këtij fakulteti për ngritjen e njohurive nga lëndët që studiojnë.

Gjashtë nga këto libra janë të autores së njohur amerikane, Louise Erdrich, e cila është një nativo-amerikane (autoktone).

Një libër tjetër është nga shkrimtarja Toni Morrison, fituese e Çmimit Nobel për Letërsi, e njohur për librin e saj "Beloved" .

Në këtë donacion të librave përfshihet edhe një libër i autores, kinezo-amerikane, Lisa See. Ajo, tërë veprimtarinë e saj letrare e ka ndarë në dy pjesë, një pjesë të saj ia ka kushtuar jetës kineze dhe një pjesë tjetër ia ka kushtuar emigracionit në SHBA, veçanërisht atij nështetin e San Franciskos.

Një libër tjetër që është botuar nga 'Komisioni i Minesotës' që është një libër multi-kulturor nga autorë me sfonde të ndryshme, i cili përmbanë ese nga njerëz me prejardhje nga shtete të ndryshme të botës.

Prof. Marry Ellen Schminder, aktivitetin e saj në Kosovë e ka filluar në AAB ku si ligjëruese mysafire për studentët e vitit të parë dhe të tretë në programin Bachelor, me të cilët po zhvillon lëndën e "TSL" (Anglishtja si gjuhë e huaj), ndërsa po ashtu do të jetë e angazhuar edhe si ligjëruese në nivelin master në Fakultetin e Gjuhës Angleze në AAB.

Ndryshe, English Corner, gjendet në objektin e III-të të Kampusit të AAB-së në Prishtinë dhe u mundëson qasje të lirë të gjithë studentëve të interesuar për leximin e literaturës anglo-amerikane.

Publikohet libri shkencor "Manaxhimi" i bashkautorëve Baki Koleci dhe Neritan Turkeshi

Në një atmosferë të bukur akademike, sot, në Qendrën Mediale Universitare të AAB-së, u bë promovimi i librit "Shqiptarët, diamantet e pagdhendur",i autorit Ylli Polovina.

Me këtë rast, Rektor i AAB-së, prof. dr. Lulzim Tafa, e duke e vlerësuar lart veprimtarinë e shkrimtarit Polovina, ndër të tjera tha:

"Në 14 vjetët e funksionimit tonë, ne kemi promovuar libra edhe të autorëve të shumtë edhe jashtë Kosovës, e sidomos të autorëve nga Republika e Shqipërisë. Në fushën e tregut të librit, AAB ka një treg krejtësisht të unifikuar me Republikën e Shqipërisë, pasi që autorët shqiptarë pa dyshim i kërkojnë lexuesit shqiptarë kudo që janë, qofshin ata në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Luginën e Preshevës dhe gjithandej."

Duke folur për librin "Shqiptarët, diamantet e pagdhendur", autori, Ylli Polovina, tha se libri është ndërtuar duke shkëmbyer opinionet me bashkëkombësit që duan të zbulojnë se çfarë mendësie kanë shqiptarët, cilat karakteristika kryesore të identitetit shfaqin, natyrën psikologjike, temperamentin apo të dhënat antropologjike të tyre.

Ky libër dëshiron të ofrojë ndihmën e vet në njohjen e tij edhe për të gjithë ata të huaj që merren me popullin dhe shtetin tonë, tha Polovina.

Z. Polovina gjithashtu bëri një përmbledhje të të gjithë librave të botuar deri më tani, por më shumë u fokusua tek veprat e botuara me temë për Kosovën.

Ylli Polovina ka lindur në Berat në Republikën e Shqipërisë. Në vitin 1970 i përfundoi studimet në Universitetin e Tiranës, ku u diplomua për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe. Ka punuar si pedagog në shkolla fil-

lore dhe të mesme, si drejtor teatri, kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë. Nga dhjetori 1997 deri në mars 2002 ishte i angazhuar në shërbimin diplomatik i Republikës së Shqipërisë në Itali. Gjithashtu, ka punuar edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë në Tiranë.

Deri tani ka botuar mbi 24 libra, nga to katër libra në gjuhë të huaj.

AAB i dhuron libra bibliotekës "Azem Shkreli"

Krahas aktiviteteve tjera, gjatë këtyre ditëve, Universiteti AAB, i ka dhuruar Bibliotekës "Azem Shkreli" në Pejë mbi 33 tituj të librave shkencor.

Përfaqësuesit e kësaj biblioteke, me rastin e pranimit të këtij donacioni, e falënderuan Universitetin AAB, ndërsa vlerësuan se këta tituj të librave janë me interes për lexuesit e bibliotekës në fjalë.

"E falënderojmë Universitetin AAB për donacionin e dhënë, në këtë mënyrë e begatoi fondin e kësaj biblioteke me botime të reja dhe me përmbajtje cilësore në shërbim të kultivimit të dijeve ndër lexuesit e kësaj biblioteke. Shpresojmë që ky hap i parë të jetë hap i bashkimit tonë të ndërsjellë".

Ky donacion i dhënë Bibliotekës "Azem Shkreli" përfshin libra shkencorë-universitar dhe të rrallë si nga fusha e ekonomisë, gazetarisë, drejtësisë, shkenca sociale, letërsi etj.

Këta tituj të librave, janë të botuar nga Shtëpia Botuese e Universiteti AAB, që njëkohësisht mbështesin direkt edhe planprogramin e këtij institucioni.

Biblioteka e AAB-së siguron qasje elektronike edhe në bibliotekën Edward Elgar Products

Biblioteka Universitare e AAB-së, si pjesë e Konzorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, ka marrë qasje elektronike edhe në njërën nga kompanitë e publikimeve mjaft të rëndësishme, në Edward Elgar Products, e cila përmban materiale elektronike të nivelit të lartë shkencor dhe akademik, si libra, revista dhe artikuj nga fushat e ekonomisë, shkencave sociale, të natyrës, të edukimit, marrëdhënieve ndërkombëtare e komunikimit masiv, të juridikut, psikologjisë etj., përfshirë librat me interes të metodologjisë hulumtuese shkencore, dhe shumë materiale të tjera me interes për studime dhe hulumtime.

Drejtori i Bibliotekës së AAB-së, Urim Sallauka, ka bërë me dije se gjatë këtij viti të ri akademik kjo bibliotekë përveç që është pasuruar edhe me më shumë tituj të librave të tjerë, ofron mundësi e qasje edhe në libraritë më të mëdha elektronike në botë si: JSTOR, ku AAB është anëtari i vetëm nga institucionet arsimore e shkencore në Kosovë që ka qasje në këto produkte, pastaj në Cambridge Journals, Oxford Reference, Oxford English Dictionary, OECD iLibrary, EBSCO etj., gjithashtu edhe në shumë portale të tjera akademike për të gjithë studentët dhe hulumtuesit shkencorë.

Një fakt shumë i rëndësishëm është se biblioteka e AAB-së është e vetmja nga institucionet jopublike arsimore në vend, që ka marrëveshje bashkëpunimi me Bibliotekën e Kongresit Amerikan për shkëmbim të materialit bibliotekar.

Qasja në këto materiale arrihet nëpërmjet ueb faqes së Universitetit AAB, http://universitetiaab.com/?page=1,286, nga të gjitha bibliotekat e të tre kampuseve universitare, në Prishtinë, Ferizaj dhe në Gjakovë.

Biblioteka e AAB-së është e hapur për studentë dhe stafin e vet çdo ditë prej orës 8:40 deri në orën 19: 00.

Një libër xhepi, i vogël, për një bibliotekë të madhe

(Recension)

Naile Demiri

Parapoezi është një vepër poetike, një përmbledhje poezish, shkruar nga poeti Bujar Tafa, botuar nga "Botimet AAB", Prishtinë 2014.

Poezia e Bujar Tafës ka një harmonizim të plotë të mendimit dhe emocionit. Imagjinata e poetit ka bërë formësimin e përmbajtjeve e formave të shprehura në këto poezi në formën më të thuktë të mundshme përmes gërshetimit estetik. Bujar Tafa në veprën poetike Parapoezi, në stilin e postmodernes, në kuptimin e plotë të fjalës, me pak vargje ishprehë shqetësimet e tij poetike.

Poezitë e Bujarit janë kryesisht krijime lirike, janë poezi të shkurtra. Poeti shprehet kryesisht në vetën e parë. Poezitë e tij karakterizohen edhe me subjektivitet, që do thotë se poeti i ka kthyer në gjuhë përjetimet e veta subjektive të botës, pa ndërmjetësimin e ndonjë ngjarje, ndonëse është dëshmitar i një momenti kohor të ndodhive, kur "gjarpri i verdhëshikon ftohtë atje ku janë palosur të vdekurit, kur gjeneralëkolaboracionistë, komandantë e komisarë, agjentë etj, pastrojnë radhët e kolonave të tyre, e më pas kthehen edukatorë të fëmijëve, vrasësit edukatorë", siç shprehet poeti.

Pra, këto poezi janë shpërthyese, kumbuese e në të njëjtën kohë edhe shqetësuese. Në poezinë e Bujar Tafës,ndonëse përshkrimi është përgjithësues, nuk mbetet pa u theksuar edhe më e imta, më individualja. Përshkimi, inkorporimi i së përgjithshmes në të veçantën dhe në atë individuale, përgjithësisht është specifikë e poezisë së Bujarit. Është specifike ngase gjallëron në kohë dhe hapësirë të caktuar duke u përshkruar me kategori më të përgjithshme.

Poeti Tafa duke i transformuar objektet e ndryshme, ato me të cilat ka ndërtuar poezinë, atyre u ka dhënë një simbolikë të gjerë dhe të thellë. Duke përdorëfigurat stilistike;metaforën, simbolin, personifikimin, metoniminë, alegorinë e mbi të gjitha satirën e sarkazmin, i ka dhënë akoma më shumë ndjesi e kuptim duke rritur shqetësimet e tij, por, njëkohësisht, edhe të lexuesit të poezisë.

Në strukturën e poezive të Tafës nuk ka ngjarje, nuk ka elemente krijuese, nuk ka fabul, nuk ka personazhe, të cilat do të vënin në lëvizje veprimin por, është intonuar me emocione të fuqishme si muzikë që njëkohësisht të tërheq dhe të refuzon, muzikë e të folurit që e ka shprehur bota e brendshme e poetit. Poezia e Bujar Tafës është e shkurtër, siç u tha më lartë, por, e përqendruar në ato pika më të ndjeshme ku përforcojnë ndenjën themelore të njerëzores.

Motivi kryesor i poetit për të shprehur shqetësimet e tij në këtë përmbledhje poezish padyshim ka lindur dhe është shfaqur si rezultat i manifestimit të një krize të thellë shoqërore që ka përfshirë shoqërinë në ditët tona, pothuajse në të gjitha poret e jetës. Më pas, motivi kryesor ka shkaktuar, vazhdimisht, edhe motive të tjera duke formuar kështu një varg motivesh statike të cilët flasin ndryshe, ndryshe për tema të njëjta.

Temat në poezinë e z Tafa janë kryesisht sociale dhe morale. Duke filluar nga poezia e parë, në këtë përmbledhje, "ADN", e deri



te poezia e fundit, "Fundi i gjithësisë", shqetësimi i poetit shfaqet ngase njerëzimit i bëhet padrejtësi nga vetë njerëzit. Trazirat dhe krizat, nga më të ndryshmet, shoqërore, të shfaqura në fundin e shekullit XX-të dhe në fillimin e shekullit XXI, ishin edhe më të mëdha, që nga fillimi i sajimit të ADN-së, siç thotë poeti"para 70 mijë viteve jetë", kur është sajuar ajo e deri tani. Kjo ADN, ka "helm gjarpri", helm që shkatërroi qytetërime të mëdha e të ndryshme, e tani duket se ia ka mësyer edhe qytetërimit tonë, dhe si i tillë, nuk evitohet, nuk shuhet, nuk zhduket, vazhdon të qenit dhe të shfaqet edhe në ditët tona, në ditët kur njeriu po tenton të bëhet zëvendës i Zotit. Duke mos pasur zgjidhje, poetit i mbetet të lutet dhe vullnetin e tij për fuqi, ta kthej në lutje: "Vllazni! Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi ne. Amin.")* f. 155.

Morali i konceptuar si "tërësi e parimeve, e normave, e rregullave që janë krijuar e ndryshojnë historikisht në kushte të caktuara shoqërore- ekonomike dhe që përcaktojnë sjelljen e veprimtarinë e njerëzve në shoqëri", në vend që të shpie kah njerëzorja dhe respektimi i të gjitha vlerave njerëzore, merr kahe negative dhe synon shkatërrimin e njerëzores dhe njeriun si tërësi. Tani, njeriu si qenie e përsosur bëhet "kanibal me smoking", bëhet "vrasësi im": "Vrasësi im i bukur, bukur më vret. Të egër e ke veç vullnetin, urinë për të ngrënë. Dhëmbi yt i bardhë, i mprehtë thikë, bukur e shqep mishin tim të kuq...)* f. 78.

Si shihet, në këtë përmbledhje të vjershave poeti ka prirje për të skalitur portrete të psikologjisë sociale të njeriut tonë.

Përmbledhja poetike "Parapoezi" e Bujar Tafës është shfaqur lirshëm. Lirshmëria në këto poezi ka arritur në shkallën më të lartë të saj.Kjo do të thotë se në poezinë e Bujarit mendimi e aktivizon lirshëm ndjenjën, prandaj këto poezi jo vetëm që janë shpërthyese, emocionale, por janë edhe më tepër racionale. Ato prekin qendrat e vetëdijes njerëzore ku fjala mund të shihet si opsion, si fuqi kreative. Jo vetëm kaq, por brenda trungut të vargut të poezisë shtrihet larmia e modelimeve poetike që lidhen me sistemin sinoptik dhe reflektojnë konstruktin poetik të librit që përfundon i përpunuar. Poezia e ndërtuar me vargje rrjedhëse është njëra nga karakteristikat e veçanta të krijimtarisë poetike të Bujarit.

Me një qasje poetike fare origjinale ndaj botes, Bujari zbulon hapësira të reja, këndvështrime të reja e të paprovuara me parë, premisa këto të cilat e bëjnë një poet të veçantë, e poeti Bujar Tafa dëshmoi sëështë i veçantë.Besoj se kritika letrare së shpejti do të merret me të dhe do të jep vlerësimin e merituar.

Evoluimi i notacionit në periudha të ndryshme

Armend Xhoni, student në Fakultetin e Muzikologjisë në AAB.

Mënyra e shkuarjes së muzikës ka filluar qysh nga kohërat e lashta.Notacioni muzikor filloi të zhvillohet paralelisht me llojin e muzikës. Grekët dhe romakët në atë kohë kishin dy lloje të shënjimit grafik të cilat përdoreshin me shkronjat e alfabetit të tyre për të simbolizuar notat. Ai notacion u quajt "Boethian " . Boethian ishte një burrështeti një filozof i shquar grek. Në vazhdim do të përmendim karakteristikat e secilit lloj të shkrimit të muzikës në periudha të ndryshme.

Notacioni në Greqinë e lashtë

Që nga koha e lashtë muzika filloi të shënjohet.Romakët dhe grekët ishin popujt e parë që filluan shënjimin e muzikës.Në këtë foto shihet një melodi e lashtë me notacionin grek. Kjo fotografi në Delfi përmban pjesën e dytë të dy himneve të Apollos. Simbolet të këtij notacioni janë shkronjat greke.

Muzika e lashtë greke shkruhej në copa guri dhe në bazë të shkronjave greke këndohej ajo muzikë e shkruar. Simbolet muzikore në Greqinë e lashtë mund të përfaqësonin lartësinë dhe gjatësinë e tingullit (por deri dikund edhe harmoninë- intervalet). Ky "sistem notal" përdorej nga shekulli VI p.e.s e deri diku rreth shekullit të IV të e.s Shumë kompozime dhe fragmente nga kompozimet e shkruara me këtë sistem mbijetuan. Shembull nga kjo mund të jetë Epitafi i Seikilos, i datuar rreth shek II p.e.s dhe shek I të e.s. Tri himne të Mesomedes nga Kreta, poashtu HymniDelphik, i datuar rreth shek. II p.e.s. Shkrimi notal grek si duket ka vazhduar të përdoret deri në rënien e Perandorisë Romake. Në Greqi dalloheshin dy lloje të notacionit: Të vjetër- për instrumente dhe të ri- për vokal.

NOTACIONI BIZANTIN

Muzika e Bizantit paraqet muzikën vokale religjioze njëzërëshe. Ajo është e bazuar në këndimin monodik modal të Greqisë së lashtë dhe këndimit të lindjes së afërme. Shënimi notal është i ngjashëm me atë të perëndimit, por në të vërtetë ai është i ndarë në masa dhe shkon nga e majta në të djathtë. Simbolet muzikore janë të ndryshme pasi që ato tregojnë drejtimin e lëvizjes së melodisë (tëlartë apo teposhtë).

Muzika bizantine është muzikë fetare vokale. Bazuar në këndim modal monodik të grekëve të lashtë.Notat shfaqen në formë të shkruar në mes masave, si një kujtesë së bashku me drejtimin e tempos nëse është e nevojshme.

Notat shtesë janë përdorur për të treguar ndryshime më të vogla se semitone.Të shtatë emrat në solfegjobizantine janë: pa, vu, g' a, d'e , ke, zo, ne.Notacioni bizantin është përdorur në shumë kisha ortodokse.

NOTACIONI NË MESJETË (NEUMET)

Për dallim nga notacioni grek dhe ai bizantin i kohës së lashtë neumet – paraqesin formën më të qëndrueshme të shkrimit notal në mesjetë. Neumet janë të shkruara në sistemin me 4 vija dhe 3 fusha (për dallim nga sistemi i sotëm 5 vijësh).

Këndimi nuk mbështete në ndonjë lartësi të caktuar tonale por gjithçka varet nga çelësi në të cilin bazohen notat – neumet

Virga dhe Punktum janë të njëjta, ndërsa Bipunktum paraqet një notë të dubluar (versioni I) apo një notë e cila rikëndohet dy herë (versioni II). Kjo edhe ka nxitë debate në mes të muzikologëve dhe se versioni i II besohet se është më i arsyeshëm dhe më i pranueshëm. Disa neume të vendosura në varg, mund të krahasohen me një rrokje, por kombinimet e mëposhtme kanë emërtime të veçanta, këto janë disa më të shpeshta. TeoricienitIsidore nga Sevilja, shkruan se "...nëse meloditë tentohen të mos shkruhen por të mbahen në mend ato mund të ndryshojnë me kohë dhe të humbin identitetin e tyre". Prandaj, me përdorimin e NEUMEVE (shenjave muzikore)do të ruhet krijimtaria muzikore. Kjoedhe ndodhi duke e përsosur sistemin notal të neumeve. Sidomos gjatë shekullit të XIX kur këtë sistem e morën në përdorim të gjitha manastiret në Evropë, sidomos për këndimin e quajtur Gregorian (nga papa Gërguri). Por, problemi ishte se orientimin me këtë sistem notal nuk ishte i mundur, pasi që melodinë e shkruar me neume nuk do të mund ta interpretonin saktë, ose më mirë thënë pa e ditur melodinë përafërsisht më herët.

Secila vijë (nga 4 vijat) emërtoheshin me një shkronjë, e cila edhe paraqiste tingullin (paralajmëronte këngëtarin për tingullin të cilin e këndonte), dhe prej kësaj edhe është marrë emërtimi i çelësave (in-G, in-F, etj).

Forma më e përpunuar e notacionit me neume është ajo korale-katrore e cila rrjedhte nga notacioni Gotik (shek.XVIII).



Mensuret

Notacioni mensural u përdor në Evropë në shek 13. Termi vjen nga teoricienët e mesjetës, të cilët kanë përdorur terma si muzika mensurate- muzika e matur ose melodi mensurabilis këngë e matshme.

Notacionimenzural ishte deri diku i saktë. Lexohej bazë lëvizjes së menzureve përafërt me notacionin modern. Gradualisht sistemi notalmenzural fillon të thjeshtohet dhe të plotësohet me shenja tjera të domosdoshme. Vija e taktit paraqet një tjetër moment me rëndësi sepse me të merr formë edhe masa, kurse me masën edhe theksi si element shumë i rëndësishëm në sistemin notal. Pas shekullit XVII deri në mesin e shekullit XX sistemi notal vazhdimisht plotësohet edhe më shenja tjera për dinamikë, artikulacion, tempo, agogjikë, duke bërë që muzika të pasurohet edhe më shumë dhe të jetë më e saktë në interpretim.

NOTACIONI TABLATURË

Është një formë e notacionit muzikor. Notacioni tablaturë është përdorur për instrumentet me tela njihet si notacioni i lahutës. Periudha në të cilën u përdor notacioni tablaturë është periudha e renesancës ku lahuta ishte instrumenti kyç dhe periudha e barokut. Në këtë notacioni shënoheshin gjashtë tela dhe fushat ashtu sinë lahutë dhe mbas numrave dhe simboleve lart luhej nota dhe vlera e sajë. Ekzistonin tabulatura të ndryshme, të cilat i përshtateshin natyrës së instrumentit, numrit të telave, numrit të tasteve, të vrimave (të instrumentet frymore). Më të njohura ishin tabulaturat për lahutë, sidomos në muzikën spanjolle.

NOTACIONI MODERN

Vlerat e notave përcaktojnë kohëzgjatjen e tyre në raport me njëra tjetrën dhe në raport me tempin e caktuar. Në sistemin e vjetër notal vlerat e notave janë shënuar me shenja të ndryshme dhe dukja e tyre krahas me kohën është ndryshuar dhe modifikuar duke arritur në pamjen të cilën e kanë sot. Secila vlerë e notës ka edhe pushimin e sajë adekuat. Tingujt shënohen me ndihmën e notave muzikore. Në mënyrë që të shënohet lartësia dhe emri i tingullit nevojitet të dihet sistemi notal, i cili përbëhet nga vijat kryesore dhe çelësat muzikorë. Notat shënohen në vija (5 vija) apo fusha (4 fusha). Përveç tyre notat muzikore mund të shënohen edhe në vijat ndihmëse nën dhe mbi pentagram. Për shkak se sistemi notal bazohet në 8 emërtime të notave (C, D, E, F, G, A,H) atëherë është bërë emërtimi i oktavave, të cilat dallojnë për nga lartësia tingujt e ndryshëm me emërtime të njëjta.

NOTACIONI KOMPJUTERIK (ELEKTRONIK)

Notacioni kompjuterik është njëra ndër mënyrat moderne të paraqitjes muzikore. Është notacion që ka shumë mundësi më të mira se gjithë notacionet tjera. Askush nuk tha se njerëzimi do të përdorte vetëm një lloj notacioni, tani notacioni grafik është një notacion shumë i përkryer për muzikën elektronike po edhe pse jo për të gjitha tjerat. Është një teknologji e re dhe lehtësim për paraqitjen e muzikës dhe ruajtjen e sajë.

Filmat që qëndruan gjatë në krye të top listave

Viti 2014 solli mjaftë filma të cilët u vlerësuan lartë nga kritika dhe u mirëpritën nga filmdashësit. Disa nga ata arritën për disa javë me radhë të jenë në krye të top listave botërore duke paraprirë me suksese dhe fitime të mëdha. Cilët janë disa nga filmat që qëndruan gjatë në krye të top listave dhe u vlerësuan lartë nga kritika mund t`i zbuloni më poshtë:

"Intersteller" i sjellur nga regjisori Christopher Nolan me aktorët Matthew McConaughey dhe Anne Hathaway në rolet kryesore sjell rrëfimin e një ekipi hulumtuesish të cilët udhëtojnë për në hapësirë, në përpjekje për të gjetur një planet potencial të banueshëm për njerëzimin. Filmi i zhanrit aventurë/fanta-shkencë zgjatë 106 min. Kritikat e filmit kanë qenë shumë të kënaqshme duke u vlerësuar si një nga filmat më të mirë të vitit 2014,me vlerësim 8.9/10. Në top 250 filmat më të mirë të gjithë kohërave,"Interstellar" zë vendin e 13. Filmi është shfaqur me 7 nëntor 2014, ku gjatë javës së parë të shfaqjes ka grumbulluar 47.510.360 $.

Një film tjetër që qëndroi gjatë në krye të top listave filmike ishte edhe filmi: **"Guardians of the Galaxy".** Një grup kriminelësh nga hapësira janë të detyruar të bashkëpunojnë për ta ndalur të tmerrshmin Ronan, abuzuesi, i cili dëshiron t`i jap fund gala kritikës. Në këtë grup përfshihet edhe një qenie njerëzore, Peter. Në regjinë e James Gun dhe në rolet kryesore:Chris Pratt dhe Zoe Saldana filmi u dha premier me 1 gusht 2014. Filmi i zhanrit aventurë/fanta-shkenë, zgjatë 121 min dhe zë vendin e 120 në top 250 filmat më të mirë të gjitha kohëve. Kritika e ka vlerësuar me 8.4/10. Në javën e parë të shfaqjes ka grumbulluar gjithsej 94.320.883 $.

"Gone Girl", si duket ka qenë një nga filmat që më së gjati ka qëndruar në krye të top listave përgjatë pesë javësh të shfaqjes së tij. Filmi i regjisorit David Fincher sjell rrëfimin e Nick, ku pas zhdukjes së gruas së tij, Amy,bëhet fokus i mediave. Ai është në qendër të vëmendjes,gjithë sytë janë drejtuar nga ai.Si i dyshuar kryesor Nick duhet të dëshmoj në çdo mënyrë pafajësinë e tij. Me Ben Affleck dhe Rosamund Pike filmi i zhanrit dramë/mister/triller,zgjatë 149 min dhe është rënditur i 86 në top 250. Është potencial për çmimin prestigjioz:"Oskar",kritika e ka vlerësuar me 8.4/10.Gjatë javës së parë filmi ka arkëtuar 37.513.109 $.

Ryan dhe Justin, dy miq të cilët vishen si polic për një mbrëmje me maska,çdo gjë duket argëtuese derisa "heronjë" bëhen pjesë e rrjetit të mafis dhe punëve të rrezikshme. Kështu duke vënë në dyshim uniformat e tyre policore. Në regjinë e Luke Greenfield filmi i zhanrit komedi: "**Let`s Be Cops**" zgjatë 104 min. Në rolet kryesore paraqitet dyshja: Jake Johson dhe Damon Wayans Jr. Kritikat kanë qenë të kënaqshme duke e vlerësuar me 6.6/10. Gjatë javës së parë filmi ka arritur të arkëtoj gjithsej 17.813.722$.

Zhanri i filmit dramë romantike: **"The Fault in our Stars"** ka qenë filmi që bëri për vete shumë filmdashës. Rrëfimi mjaftë prekës i Hanzel dhe Gus, dy adoleshentët e sëmurë me kancere të ndryshme, të cilët dashurohen pas takimit të tyre të parë në grupin e të prekurve nga kanceri. Filmi i regjisorit Josh Bonne, arriti të përfolej shumë duke përfshirë paraqitjen e mrekullueshme të Shalene Woodley dhe të Ansel Egort.8.1/10 është vlerësimi nga kritika. Filmi zgjatë 126 min dhe ka grumbulluar në javën e parë në shfaqjen e tij me 6 qershor 2014,gjithsej 48.002.523 $.

Punoi:
Egzon Dervishi,
student, AAB-Gjakovë

Samsung përgatit modelin e ri të telefonit me ekran 5.5 inç

Samsung, lideri global i telefonave të mençur mobil që pritet ta lëshojë gjeneratën e re të telefonit të saj Galaxy S6 vitin e ardhshëm, besohet se tani është duke punuar në një model tjetër me specifika të avancuara, të cilin do ta lëshojë edhe para Galaxy S6 – për ta rikuperuar profitin e humbur nga shitja e dobët e telefonit të saj të fundit, S5.
Sipas një listimi zyrtar të Samsung thuhet se modeli i ri i telefonit i koduar me shifrën SM-G430 është konfirmuar, dhe madhësia e ekranit të këtij modeli do të jetë me 5.5 inç.
Ekzistenca e Samsung SM-G430 më pas është konfirmuar edhe nga portali indian për importe dhe eksporte Zauba, i cili thotë se çmimi i këtij modeli do të jetë rreth 326 funta.
Karakteristikat e tjera të modelit të ri të telefonit të Samsung janë zbuluar aksidentalisht nga vetë faqja e Samsung.
Sipas informacioneve aktuale thuhet se Samsung SM-G430 do të ofrojë ekranin me 5.5 inç dhe rezolucion prej 1080 x 1920 pikselëve, Android 4.4.4 KitKat, si dhe procesorin 2.5GHz quad-core Qualcomm Snapdragon 801.
Megjithatë, për detajet tjera rreth këtij modeli është ende herët të flitet, mirëpo besohet se Samsung nuk do të kursehet në tentimin e saj për ta krijuar një model të avancuar, pas dështimeve me shitjet e telefonave të saj, në nivel global.

Apple përgatitet për iPhone Mini?

Disa thonë që iPhone 6 është shumë i madh. Mirëpo në treg deri më tani janë shitur shumë më shumë njësi të iPhone 6 me ekran më të madh, sesa modelet paraprake të iPhone.

Por, për të gjithë ata që ende mendojnë se modelet e reja të iPhone nga Apple janë shumë të mëdhenj në ekran, kompania thuhet se është duke menduar edhe për versionin minimal të iPhone, të cilin do ta quajë 'iPhone mini' dhe të cilin do ta prezantojë në vitin 2015.
Me fjalë të tjera, nëse kjo ndodhë, atëherë i bie që Apple të kthehet në telefonat e saj standard me ekranin me diagonalen prej 4 inç.
Të paktën kështu është thënë nga analisti Timothy Arcuri i Cowen & Company. Sipas Arcuri, Apple do ta prezantojë iPhone 6s vitin e ardhshëm, me dimensionet e iPhone 5s por dizajnin e iPhone 6.

Majlinda Kelmendi kampione absolute e xhudos në botë

Krenaria e sportit kosovar, Majlinda Kelmendi, e fitoi epitetin e xhudistes më të mirë në të gjitha kategoritë për vitin 2014.

E, përveç që e mori një epitet të tillë tejet të çmuar, ajo pranoi edhe një shumë simbolike për sukseset e saj të madhe këtë vit.

Presidenti i Federatës Botërore të Xhudos, Marius Vizer, i dorëzoi Kelmendit një ek prej 50 mijë eurosh për sukseset e saj gjatë 2014-ës.

Xhudistja shqiptare nga Kosova, Majlinda Kelmendi nuk kishte të ndalur. Pasi u stolis me Medaljen e Artë në turneun prestigjioz të xhudos "World Masters", i cili është mbajtur në qytetin rus Tyumen, ajo ka arritur një tjetër rezultat të madh.

Xhudistja pejane ka fituar Medaljen e Artë, në kategorinë 52 kilogramë, në kampionatin botëror të xhudos, i cili u mbajt në Rio de Janeiro.

Pas gjitha këtyre sukseseve ne sportin e xhudos, Majlinda është duke vijuar studimet në Fakultetin e Kulturës Fizike në AAB, ku edhe aty është duke treguar aftësi të shkëlqyera në studime.

Haxhi Krasniqi vetëm një hap larg titullit të botës në boks



Në meqin e fundit, boksieri junikas Haxhi Krasniqi ka shënuar fitore kundër polakut, Dariusz Sek duke e hapur rrugën për titullin botëror. Ai arriti që për mrekulli t'i mbrojë titujt që zotëron WBA Continental dhe WBO International.

Krasniqi që ka nënshtetësi gjermane, ka arritur që për mrekulli t'i mbrojë titujt që zotëron në WBA Continental dhe WBO International, ndërsa kjo fitore, tani i hap rrugën për të luftuar për titullin e botës në WBA.

Në meçin që zgjati 12 raunde, Krasniqi tregoi edhe një herë se ishte më i përgatitur se boksieri polak, ndërsa në këtë fitore, shumë e ndihmuan edhe bashkëvendësit shqiptarë, që kishin mbushur sallën ku zhvillohej meçi. Boskieri junikas u tregua më i mirë se polaku në këtë me, duke fituar me vendim unanim të gjyqtarëve, 115:113, 116:112, 116:112.

Haxhiu ishte veçmas i mirë në tre raundet e para si dhe në raundet 10-të e 11-të, duke e fituar këtë duel tejet të rëndësishëm për karrierën e tij. Ai tani do ta ketë duelin e radhës kundër Jurgen Brahmer (WBA) ose Sergey Kovalev (WBO) dhe synimi i tij është titulli i kampionit botëror. Do theksuar se ky meç u transmetua ekskluzivisht në RTK 1, duke i dhuruar emocione të mëdha bashkëkombësve tanë kudo që jetojnë, e të cilët Haxhi Krasniqi i përshëndeti dhe i falënderoi për përkrahjen pas përfundimit të meçit në intervistën e dhënë në ring.

Dionis Avdijaj, talenti i madh i Schalke 04

Njëri ndër talentët më të mëdhenj të futbollit gjerman, kosovari Donis Avdijaj, pritet që së shpejti të bëjë debutimin e tij në Bundesligë në skuadrën e tij Schalke 04.

"Unë jam duke shkuar në një rrugë të mirë. Ndërrimi i trajnerëve e ka bërë të veten, por edhe trajneri i ri Roberto Di Matteo, çdoherë me provon në skemat e ekipit të parë dhe shumë shpejt pres që të debutoj me Schalke-n", tha Avdijaj për KNN-në.

Ai është konsideruar si njëri nga talentët më të mirë në Bundesligë, ku edhe interesimet e skuadrave të mëdha evropiane janë shumë të mëdha që ta kenë sulmuesin kosovar në ekipin e tyre.

Mirëpo, Avdijaj tha tani për tani, përkundër ofertave të mëdha, nuk planifikon të largohet nga Schalke.

"Schalke po bën gjithçka për mua dhe nuk jam duke e menduar për largim, pasi që jam shumë i lumtur këtu", theksoi sulmuesi kosovar i Schalke-s, Donis Avdijaj.

Gëzuar 2015
Sharri®
UJË NATYRAL / NATURAL WATER
Nga Zemra e Brezovicës
Uji më i mirë në vend.

Model Slovenia
CONSTRUCTION

Gëzuar 2015

Bleje banesën me **këste**
për **3 vite pa kamatë**

Prishtinë – Kosovë, Tel: +386 (0)49 672 000, +377 (0)45 295 006,+386 (0)49 132 056
web: www.modelslovenia.com , mail: info@modelslovenia.com

PRISHTINË
Institucioni i Arsimit
UNIVERSITAR AAB
GËZUAR
FESTAT
HAPPY HOLIDAYS